

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE NË GJYKATA NË VITIN 2020

Një raport prezantues mbi disponueshmërinë e mjeteve të IT-së dhe udhëzimeve mbi mbledhjen e të dhënave, bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e (CEPEJ) për vlerësimin e sistemeve gjyqësore



Shkurt 2022

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE NË GJYKATA NË VITIN 2020

Një raport prezantues mbi disponueshmërinë e mjeteve të IT-së dhe udhëzimeve mbi mbledhjen e të dhënave, bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e (CEPEJ) për vlerësimin e sistemeve gjyqësore

Shkurt 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesat	5
Hyrje	6
Metodologjia, qëllimet dhe struktura e raportit	7
PJESA 1 - Konsiderata të përgjithshme metodologjike	10
PJESA 2 - Buxheti dhe burimet njerëzore	12
2.1. Buxheti për kompjuterizim.....	12
2.2. Personeli i TI-së në gjykata	15
PJESA 3 - Përdorimi i TI-së në gjykata.....	18
3.1. Përdorimi i TI-së në gjykata gjatë pandemisë	18
3.2. Vlerësimi i ndikimit të projekteve të TI-së.....	18
3.3. Siguria e sistemit të informacionit të gjykata dhe mbrojtja e të dhënave	20
3.4. Databaza të centralizuara për mbështetje të vendimeve	21
3.4.1. Databaza nacionale e centralizuar e vendimeve të gjykatave (praktika gjyqësore, etj.)	21
3.4.2. Një regjistër penal nacional i kompjuterizuar që i centralizon të gjitha dënimet penale	25
3.5. Mjete ndihmëse shkrimi.....	26
3.5.1. Mjetet ndihmëse shkrimi, siç janë modelet e shablloneve.....	26
3.5.2. Mjetet e incizimit të zërit	27
3.5.3. Sajti i intranetit	29
3.6. Përdorimi i TI për përmirësimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor	30
3.6.1. Sistem për menaxhim të lëndëve	30
3.6.2. Regjistra të kompjuterizuar të menaxhuar nga gjykatat.....	35
3.6.3. Sistemet e gjykatave për menaxhim buxhetor dhe financiar	36
3.6.4. Mjetet e matjes për të vlerësuar ngarkesën e punës së gjyqtarëve dhe personelit jo-gjyqtar	38
3.7. TI e përdorur për komunikime ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe përdoruesve të gjykatave.....	40
3.7.1. Paraqitja e një lënde në gjykatë përmes mjeteve elektronike.....	41
3.7.2. Parashtrimi i kërkesës për ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike	42
3.7.3. Transmetimi i thirrjeve për seancë përmes mjeteve elektronike.....	44
3.7.4. Komunikimi elektronik midis gjykatave dhe avokatëve dhe/ose palëve	46
3.7.5. Komunikimi elektronik i përdorur nga profesionistë të tjerë përveç avokatëve.....	49
3.7.6. Sistemet e përpunimit online të proceseve gjyqësore të specializuara	51
3.7.7. Video-konferenca midis gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve	52
3.7.8. Incizimi i seancave	53
3.7.9. Provat elektronike	55
PJESA 4 - Përmbledhje e fushave për veprime të mëtejshme dhe rekomandime.....	57
SHTOJCA I - Pyetësori i plotësuar i CEPEJ për TI për Kosovën (të dhënat e vitit 2020)	62

Ky publikim u prodhuan me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës Instrumenti Horizontal II – projekti KOSEJII. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, 2022”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t’i drejtohen ‘Directorate General of Human Rights and Rule of Law’

@ Këshilli i Evropës, 2022. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Kopertina: Shutterstock

Shkurtesat

CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
EOP	Ekuivalent me orar të plotë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KoSEJ II	Projekti “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Kosovë”
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
NCCR	Sistemi Kombëtar Qendror i Evidencës Penale (National Centralised Criminal Records System)
SMIL	Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve
TI	Teknologjitë e informacionit

* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Sistem efikas i drejtësisë kontribuon në rritjen e besimit të publikut në autoritetet shtetërore dhe është thelbësor për konsolidimin e demokracisë dhe forcimin e sundimit të ligjit. Gjatë dy dekadave të fundit, Teknologjia e Informacionit (TI) ekziston gjithnjë e më shumë në një numër të madh gjykatash në vendet evropiane (të emëruar si e-drejtësia, e-gjykata, drejtësia kibernetike, drejtësia elektronike, etj.).¹ Qëllimi përfundimtar i përpjekjeve të tilla është sigurimi i një qasjeje më të mirë në drejtësi, procedura më të lehta në fusha të ndryshme të së drejtës (civile, penale dhe administrative) dhe një bashkëpunim më i ngushtë midis gjyqësorit dhe autoriteteve të tjera publike.

Kohët e fundit, pandemia COVID-19 ka ekspozuar rëndësinë dhe potencialin e teknologjisë në fushën e drejtësisë (dhe në të tjerat). Qasja e pandërprerë në gjykata duhet të garantohet edhe gjatë kohës së emergjencës, në veçanti, për të siguruar shqyrtimin gjyqësor të legjislacionit të emergjencës, por edhe në lidhje me rastet urgjente (p.sh., kur përfshihet liria dhe siguria e personave) dhe për të mbështetur qasjen në drejtësi në përgjithësi. Për ta trajtuar këtë, gjykatat kanë miratuar një numër masash, pothuajse të gjitha që përfshijnë zhvendosjen drejt ofrimit të drejtësisë nga distanca dhe përmes platformave në internet.²

Në qershor 2020, CEPEJ miratoi edhe një “Deklaratë për mësimet e nxjerra dhe sfidat me të cilat përballlet gjyqësia gjatë dhe pas pandemisë COVID-19” renditja e 7 parimeve që duhet të vazhdojnë të respektohen në një periudhë krize që ndikon në shërbimin publik të drejtësisë. Parimet gjithashtu përfshijnë Qasjen në drejtësi, ku “Shërbimi publik i drejtësisë duhet të ruhet sa më shumë që të jetë e mundur, duke përfshirë sigurimin e qasjes në drejtësi me mjete alternative siç janë shërbimet në internet ose forcimin e qasjes në informacion përmes uebsajteve të gjykatave dhe mjeteve të tjera të komunikimit (telefon, email, etj.).”

Ndërsa vendet dalin nga gjendja e jashtëzakonshme, është e rëndësishme që qeveritë dhe palët e interesit gjyqësor të bëjnë një vlerësim të teknologjive në dispozicion (ekzistuese dhe/ose të vëna në funksion gjatë pandemisë), avantazhet dhe disavantazhet e tyre, si dhe ndikimin e tyre tek përdoruesit e gjykatave dhe ofrimi i drejtësisë.

Në Kosovë, gjatë shpërthimit të pandemisë COVID-19 në vitin 2020, disa praktika të reja filluan të zbatohen në gjykata, duke përdorur mjete elektronike: një numër i vogël seancash filluan të mbahen online; disa gjyqtarë pranuan disa kërkesa dhe dosje të paraqitura me email nga palët; dhe disa ftesa nga gjykatat iu dërguan avokatëve në mënyrë elektronike. Ky raport synon të inkurajojë palët e interesuara gjyqësore që të përfitojnë nga ato praktika të reja dhe të rishqyrtojnë disa aspekte të funksionimit tradicional të gjykatave. Përpunimi i një vlerësimi të përgjithshëm gjithëpërfshirës të Teknologjisë së Informacionit ekzistues në sektorin e drejtësisë (gjykatat, prokuroritë, shërbime të tjera të lidhura me drejtësinë) do të ofronte bazën e nevojshme për diskutime të mëtejshme mbi dixhitalizimin. Prandaj, ky raport për përdorimin e TI-së në gjykatat në Kosovë është mu në kohën e duhur.

1 CEPEJ, “Përdorimi i teknologjisë së informacionit në gjykatat evropiane”, sistemet gjyqësore evropiane, efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë, STUDIMET CEPEJ Nr. 24, gjenden në: <https://rm.coe.int/european-judicial-systems-efficiency-and-quality-of-justice-cepej-stud/1680788229>

2 OSBE ODIHR, “Funksionimi i gjykatave në pandeminë Covid-19: abetare”, tetor 2020, gjendet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/5/5/469170.pdf>. Shih edhe përpilimin e komenteve nga CEPEJ, <https://www.coe.int/en/web/cepej/compilation-comments>. Përpilim masash bërë nga CEPEJ në fillim të krizës shëndetësore dhe përditësohet rregullisht.

Metodologjia, qëllimet dhe struktura e raportit

Ky raport është bazuar në metodologjinë dhe treguesit e CEPEJ dhe, në veçanti, në pyetjet e TI -së në Skemën e Vlerësimit të CEPEJ të përdorura për vlerësimin e sistemeve gjyqësore (në tekstin e mëtejshme, edhe Pyetësori i CEPEJ për TI) dhe Shënimi Shpjegues shoqërues.³ Duke ruajtur një fokus të veçantë në TI, raporti bazohet në vlerësimet e mëparshme të efikasitetit dhe cilësisë së sistemit të drejtësisë në Kosovë, të kryera në 5 vitet e fundit, bazuar në metodologjinë CEPEJ për vlerësimin e sistemeve gjyqësore.⁴

Raporti ndjek një qëllim të dyfishtë:

- Së pari, ai ofron një shqyrtim prezantues të vendosjes dhe disponueshmërisë së TI-së në gjykatat e Kosovës deri në vitin 2020. Qëllimi është të identifikohen fushat ku mjetet e TI-së mund të përdoren ndoshta për të rritur më tej efektshmërinë dhe cilësinë e sistemit gjyqësor. Disa informacione sasiore dhe cilësore të raportuara dhe analizuara në këtë raport i referohen vitit 2021. Sidoqoftë, u pranua se krijimi i një grupi të dhënash për vitin 2020 do të siguronte një bazë shumë të dobishme për t'u përdorur si referencë në raportet e ardhshme për matjen e trendeve, evolucioneve dhe çështjeve strukturore në vitet e ardhshme.
- Së dyti, raporti shpjegon se si të plotësohet pyetësori i IT CEPEJ duke ofruar një listë të qartë dhe sistematike të pyetjeve të IT, shpjegimet shoqëruese si dhe përgjigjet e lidhura për të lehtësuar përdorimin e metodologjisë CEPEJ, koncepteve dhe treguesve të zhvilluar dhe përdorur nga CEPEJ në këtë drejtim. Si e tillë, ai gjithashtu shërben si mjet trajnimi për përfituesit, duke i ndihmuar ata në përgjigjen e duhur të pyetjeve në këtë rast dhe në kontekstin e vlerësimeve të ardhshme. Përdorimi i vazhdueshëm i metodologjisë në vlerësimet e ardhshme do të mundësonte për më tepër krahasueshmërinë e gjetjeve (përfshirë me vendet/entitetet e tjera evropiane) dhe identifikimin e trendeve/evolucioneve të mundshme me kalimin e kohës.

Përfshirja e rekomandimeve ndihmon në identifikimin e fushave për veprime të mëtejshme, në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet nga vlerësimet e mëparshme dhe me parimet e përcaktuara në dokumentet e CEPEJ, të tilla si Udhëzimet se si të nxitet ndryshimi drejt drejtësisë kibernetike,⁵ pakoja e mjeteve për mbështetjen e zbatimit të udhëzimeve,⁶ dhe mjetet e zhvilluara nga Grupi Punues i krijuar kohëve të fundit për Drejtësi Kibernetike dhe Inteligjencë Artificiale brenda CEPEJ.⁷

Siç shpjegohet në Raportin e Vlerësimit të CEPEJ të nxjerrë në vitin 2020 (të dhënat e vitit 2018), pyetësori i CEPEJ për TI mbledh të dhëna për tri kategori të mjeteve të TI-së, të cilat më pas mundësojnë llogaritjen e

3 Skema e Vlerësimit të CEPEJ mund të shkarkohet këtu: <https://rm.coe.int/cepej-grille-en-rev7/native/168093addf> ndërsa Shënimi Shpjegues mund të gjendet këtu: <https://rm.coe.int/cepej-shenim-shpjegues-2020-2022/1680a1fbb2>. Për pyetjet e TI-së, shihni "3.5 Përdorimi i teknologjive të informacionit në gjykata", nga pyetja 62-1 deri në 64-12. Për qëllimet e këtij raporti, përgjigjet e pyetjeve 62-1, 65-1, 65-2 dhe 65-3 nën "Politikat e përgjithshme në teknologjinë e informacionit në sistemet gjyqësore" nuk janë përfshirë në këtë raport pasi qeverisja e TI-së në sektori i drejtësisë është ende objekt i diskutimeve ndërinstitucionale në Kosovë.

4 Raporti i Vlerësimit të Thellë të Sistemit Gjyqësor, janar 2018 (raporti i parë): <https://rm.coe.int/in-depth-assessment-report-of-the-judicial-system/16807828e6>; Vlerësimi Krahasues i Sistemit Gjyqësor, nga 2014 deri në 2017 (raporti i dytë): <https://rm.coe.int/comparative-assessment/1680939684>; Vlerësimi Krahasues i Sistemit Gjyqësor në Kosovë (2014, 2017 dhe 2018) (raporti i tretë): <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/942440FA-DA73-4A93-AFCC-0D0B5B01845D.pdf>

5 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), Udhëzime mbi mënyrën e drejtimit të ndryshimit drejt Drejtësisë Kibernetike, [Mbledhja e mjeteve ekzistuese dhe përmbledhja e praktikave të mira], CEPEJ(2016)13E / 7 dhjetor 2016, gjendet në: <https://rm.coe.int/16807482de>.

6 CEPEJ, Pakoja e mjeteve për mbështetjen e zbatimit të Udhëzimeve se si të nxitet ndryshimin drejt Drejtësisë kibernetike, 14 qershor 2019, gjendet në <https://rm.coe.int/cepej-toolkit-cyberjustice-en-cepej-2019-7/168094ef3e>, 07 qershor 2021.

7 Grupi Punues për Drejtësi kibernetike dhe Inteligjencë Artificiale (CEPEJ-GT-CYBERJUST). Mjetet që do të zhvillohen nga ky Grup i ri Punues duhet të përfshijnë tema të ndryshme si kriteret e cilësisë për video-konferencat, inteligjencën artificiale të përdorur në metodat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ose zbatimin e vendimeve gjyqësore ose procedurave gjyqësore në një kontekst digjital: <https://www.coe.int/en/web/cepej/cepej-working-group-cyber-just>. Shih në veçanti Udhëzimet për video konferencën për procedurat gjyqësore të miratuara nga CEPEJ më 16-17 qershor 2021: https://www.coe.int/en/web/cepej/home/-/asset_publisher/CO8SnxljXPeD/content/la-cepej-adopte-ses-lignes-directrices-sur-la-video-conference-dans-les-procedures-judiciaires?inheritRedirect=false&redirect=https%3A%2F%2Fwww.coe.int%2Fen%2Fweb%2Fcepej%2Fhome%3Fp_id%3D101_INSTANCE_CO8SnxljXPeD%26p_p_lifecycle%3D0%26p_p_state%3Dnormal%26p_p_mode%3Dview%26p_p_col_id%3Dcolumn-1%26p_p_col_count%3D8

Indeksit të përgjithshëm të disponueshmërisë së TI-së (shkalla 0-10):⁸

- i. Teknologjitë mbështetëse të vendimeve të cilat përfshijnë databazat e vendimeve gjyqësore, ekzistencën e një regjistri kombëtar të dënimeve penale, mjetet e ndihmës në shkrim dhe incizimin e zërit duke përfshirë veçoritë e njohjes së zërit;
- ii. Sistemet e menaxhimit të gjykatave dhe lëndëve, të cilat përfshijnë sistemet e menaxhimit të lëndëve (përfshirë ndërveprimin e tyre, menaxhimin aktiv të lëndëve dhe funksionalitetet e statistikave), sistemet e menaxhimit buxhetor dhe financiar të gjykatave, dhe mjetet e vlerësimit të ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe stafit administrativ;
- iii. Komunikimi midis gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve të gjykatave, i cili përfshin mundësinë e paraqitjes së një lënde elektronikisht, kryen shkëmbim komunikimi brenda fazave të ndryshme të një lënde midis gjykatës, palëve, avokatëve dhe profesionistëve të tjerë, ekzistimi i procedurave të specializuara në internet, video-konferenca dhe incizimi i seancave.

Raporti i Vlerësimit i CEPEJ thekson se pyetësi mbledh të dhëna për disponueshmërinë e mjeteve të TI-së, jo për përdorimin e tyre real. Ai shton se “një nivel i lartë zhvillimi nuk do të thotë domosdoshmërisht një përdorim real dhe ndikim pozitiv në efikasitetin ose cilësinë e gjykatave të shërbimit publik të drejtësisë.”

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga palët e interesit, pyetësi i CEPEJ për TI për Kosovën për vitin 2020 u plotësua (shih Shtojcën I) dhe Indeksi i përgjithshëm i disponueshmërisë së TI-së u llogarit me mbështetjen e Sekretariatit të CEPEJ (shih Shtojcën II). Plotësimi i pyetësorit dhe llogaritja e indeksit të TI-së janë të lidhura ngushtë dhe do të ndihmojnë në monitorimin e progresit me kalimin e kohës në lidhje me disponueshmërinë e TI-së në gjykata.

Indeksi i përgjithshëm i vendosjes së TI-së për Kosovën në vitin 2020 ishte 3,23 nga 10.

Sipas kategorisë	Mbështetja e vendimeve	Gjykatat dhe menaxhimi i lëndëve	Komunikimi ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve të gjykatave
	3,65	4,73	1,28

Sipas lëndëve	Administrative	Civile	Penale
	2,82	2,80	3,50

Ky indeks duhet të shihet si një referencë për 10, që do të thotë se 10 është pika maksimale e mundshme në vitin e vëzhgimit. Për më tepër, duke pasur parasysh se Raporti i Vlerësimit të CEPEJ-it shqyrton të dhënat e vitit 2018, dhe jo të dhënat e vitit 2020, indeksi për Kosovën në vitin 2020 nuk mund të krahasohet plotësisht me indeksin e vendeve/entiteteve të ndryshme evropiane të listuara në atë raport. Në vitin 2018, siç është paraqitur në Raport, indeksi mesatar i përgjithshëm i vendosjes së TI-së në vitin 2018 për Evropën ishte 6,11.

Në dhjetor 2020, procesi i mbledhjes së të dhënave u lansua nga Projekti KoSEJ II, me mbështetjen e ekspertës ndërkombëtare të CEPEJ, Dr. Julinda Beqiraj, Studiuese e lartë në Qendrën Bingham për Sundim të Ligjit (BII-CL). Përgjigjet e hershme në pyetjet në pyetësorin e TI-së të CEPEJ-it janë mbledhur nga departamenti i TI-së, departamenti për buxhet dhe departamenti për personel në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Këto më vonë u plotësuan me të dhëna cilësore shtesë e mbledhur nga palët e tjera të interesit, duke përfshirë gjyqtarët nga gjykatat themelore dhe Gjykata e Apelit (përmes takimeve personale si dhe në intervistat me email), zyrtarët e informacionit në gjykata, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, disa avokatët, departamentin për buxhet dhe departamentin për personelin në KGJK, dhe një zyrtar financiar në njërin nga gjykatat themelore. Të dhëna të tilla u mbledhën nga këshilltarët lokal të KoSEJ II, u rishikuan si pjesë e kontrollit të rregullt të cilësisë

8 Raporti i Vlerësimit i CEPEJ i hartuar në vitin 2020 (të dhënat e vitit 2018), f. 99: <https://rm.coe.int/evaluation-report-part-1-english/16809fc058> (nga faqja 95 deri në 104 për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, TIK). Shih edhe fajlin e veçantë - Raporti “Sistemet gjyqësore evropiane - Raporti i Vlerësimit i CEPEJ - Cikli i vlerësimit, 2020 (të dhënat e vitit 2018): <https://www.coe.int/en/web/cepej/special-file-publication-of-the-report-european-judicial-systems-cepej-evaluation-report-2020-evaluation-cycle-2018-data->

së CEPEJ-it dhe u inkorporuan në kuadrin e pyetësorit të TI-së të CEPEJ-it nën pyetjet përkatëse. Më 21 tetor 2021 u zhvillua një seminar për të paraqitur dhe diskutuar draftin e raportit. Përfaqësuesit nga institucionet përkatëse përfituese, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Sekretariati CEPEJ dhanë kontribut konstruktiv për shtesat dhe/ose amendamentet në disa seksione, të cilat u inkorporuan në draftin përfundimtar. Raporti përbëhet nga katër pjesë:

- Pjesa 1 përmban konsiderata të përgjithshme metodologjike për plotësimin e pyetësorit CEPEJ për TI. Ajo nxirret drejtpërdrejt nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ që shoqëron Skemën e Vlerësimit të CEPEJ.⁹
- Pjesa 2 fokusohet në buxhetin për kompjuterizimin dhe stafin e TI-së në gjykatat e Kosovës.
- Pjesa 3 përmban thelbin e vlerësimit të këtij raporti mbi përdorimin e TI-së në gjykatat në Kosovë. Ajo së pari diskuton shkurtimisht ndikimin e COVID-19 në sistemin gjyqësor në Kosovë, sa i përket sfidave dhe mundësive, dhe më pas ndjek renditjen e pyetjeve në pyetësorin e CEPEJ për TI. Për secilën pyetje, skema e prezantimit dhe analizës është e njëjtë, dhe përfshin:
 - pyetjen siç është përfshirë në pyetësorin e CEPEJ për TI;
 - një shpjegim metodologjik të koncepteve të përdorura, përkufizimeve dhe indikacioneve se si të plotësohen tabelat përkatëse (të nxjerra nga metodologjia e CEPEJ);
 - njohuri mbi kontekstin në lidhje me situatën ligjore dhe praktike në Kosovë, përfshirë rekomandimet aty ku është e përshtatshme.
- Pjesa 4 përmban një përmbledhje të rekomandimeve të dhëna në secilin seksion.

Raporti gjithashtu përmban një shtojcë:

- Shtojca I me pyetësorin e plotësuar të CEPEJ për TI për Kosovën (të dhënat e vitit 2020), që përdoret si model për vlerësimet e ardhshme, si dhe

9 CEPEJ, "Shënim Shpjegues i Skemës për vlerësimin e sistemeve gjyqësore", cikli 2018 - 2020, gjendet: <https://rm.coe.int/cepej-explanatory-note-25-mars/168093ad3e>

PJESA 1 - KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME METODOLOGJIKE

Më poshtë janë disa konsiderata të përgjithshme metodologjike për plotësimin e pyetësorit të CEPEJ për TI. Ato nxirren drejtpërdrejt nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ që shoqëron Skemën e Vlerësimit të CEPEJ.

Përgjigjet me NA (Nuk ka) dhe NAP (Nuk aplikohet)

Gjatë përgjigjes së pyetjeve, nuk mund të jetë gjithmonë e mundur të jepni një numër ose të zgjidhni midis modaliteteve të ndryshme të përgjigjeve (Po ose Jo). Në këto raste, përkatësisht NA (Nuk ka) ose NAP (Nuk aplikohet) mund të përdoren.

NA (informacioni/të dhënat nuk janë në dispozicion) do të thotë se koncepti/kategoria e referuar në atë pyetje ekziston në sistemin gjyqësor në Kosovë, por që nuk e dini përgjigjen/të dhënat (p.sh. lëndët administrative ekzistojnë në sistemin gjyqësor, por nuk mund ta përcaktoni sasinë e numrit të këtyre lëndëve administrative).

NAP (nuk aplikohet) do të thotë që pyetja nuk është relevante për sistemin gjyqësor në Kosovë (për shembull, sepse kategoria e personelit gjyqësor ose lloji i kontesteve të referuara në pyetje nuk ekziston në sistemin gjyqësor).

Përgjigjet me NA ose NAP janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, ju lutemi respektoni këto rregulla, çdo gabim do të çojë në interpretime të gabuara. Rregullat e qëndrueshmërisë (vertikale dhe horizontale) nuk aplikohen në të njëjtën mënyrë në prani të një ose më shumë përgjigjeve NA ose NAP.

Komente

Për shumicën e pyetjeve ekziston edhe një seksion komentesh. Ekzistojnë dy lloje të komenteve: komente të përgjithshme dhe komente specifike. Këto duhet të etiketohen qartë dhe të paraqiten veçmas.

“Komentet e përgjithshme” duhet të përmbajnë informacione që *vlejnë për të gjitha ciklet e vlerësimit*. Kur një përgjigje dhe/ose një koment për një pyetje specifike mbetet i pandryshuar nga vlerësimi i mëparshëm, ai duhet të “kopjohet dhe vendoset” nga formulari i mëparshëm. “Komentet specifike” duhet të japin informacion të detajuar për specifikat/ndryshimet në sistemin gjyqësor kombëtar ose në metodologjinë e raportimit në një *cikël specifik vlerësimi*.

Në një ushtrim kryesisht vlerësues cilësor si ky për përdorimin e TI-së në gjykata, komentet luajnë një rol thelbësor në sigurimin e kontekstit dhe plotësimin e përmbajtjes së pyetjeve me zgjedhje të shumëfishta. Komentet duhet të jenë sa më precize, gjithëpërfshirëse dhe sa më koncize që të jetë e mundur.

Kontrollimi dhe variacionet nga vlerësimet e mëparshme

Ju lutemi kontrolloni gjithmonë të dhënat e futura. Ju lutemi krahasoni të dhënat e treguara për vitin e referencës me ato të dhëna për raundet e mëparshme të vlerësimeve dhe shpjegoni variacionet e konsiderueshme nga një cikël në tjetrin (p.sh. variacionet për shkak të reformës strukturore, ndryshimit legjislativ, metodologjisë së ndryshme ose një ndryshimi në interpretimin e pyetjes nga korrespondenti kombëtar).

Valuta

Të gjitha shumat financiare duhet të jepen në Euro.

Rregullat dhe përjashtimet

Ju lutemi përgjigjuni, nëse është e mundur, sipas gjendjes së përgjithshme në vendin tuaj dhe jo sipas përjashtimeve. Ju mund të paraqitni përjashtime nga rregullat në fushën e komenteve poshtë pyetjes.

Burimet

Ju lutemi paraqitni burimet e të dhënave tuaja, nëse është e mundur kur kërkohet. “Burimi” ka të bëjë me institucionin i cili ka siguruar informacionin për të dhënë përgjigjen në pyetjen (p.sh. KGJK, KPK, Gjykatat, Agjencia e Ndhmës Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë, projekte ndërkombëtare si NCCR, etj.). Kjo do të ndihmojë në kontrollimin e besueshmërisë së të dhënave.

Rekomandimi 1: Vlerësimi rregullisht i disponueshmërisë së TI-së në gjykata në Kosovë, bazuar në metodologjinë e CEPEJ, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të tyre.

Plotësimi i pyetësorit dhe llogaritja e indeksit të përgjithshëm të disponueshmërisë së TI-së janë të lidhura ngushtë dhe do të ndihmojnë në monitorimin e progresit me kalimin e kohës në lidhje me disponueshmërinë e TI-së në gjykata. Gjatë plotësimit të pyetësorit, duhet të regjistrohen informacionet e mëposhtme për raportet e ardhshme: zyrtari pranë institucionit përkatës që ka dhënë përgjigjen për një pyetje specifike (të dhënat e kontaktit të tij/saj) dhe të gjitha komentet përkatëse. Kjo do të ndihmojë në raportet e ardhshme për të siguruar konsistencën e përgjigjeve (dhe për të shmangur një interpretim të ndryshëm të pyetjes) dhe për të identifikuar evolucionet e mundshme.

PJESA 2 - BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

2.1. Buxheti për kompjuterizim

6. Buxheti publik vjetor (i miratuar dhe realizuar) i ndarë për funksionimin e të gjitha gjykatave, në € (pa buxhetin e shërbimeve të prokurorisë publike dhe pa buxhetin e ndihmës juridike). Nëse nuk mund ta ndani buxhetin e alokuar për gjykatat nga buxhetet e shërbimeve të prokurorisë publike dhe/ose ndihmës juridike, ju lutemi shkoni te pyetja 7. Nëse jeni në gjendje t'i përgjigjeni pyetjes 6, ju lutemi përgjigjuni NA pyetjes 7.

	Buxheti i miratuar (€)	Buxheti i realizuar (€)
GJITHSEJ - Buxheti vjetor publik i alokuar për funksionimin e të gjitha gjykatave (1 + 2 + 3 + 4 + 5 + 6 + 7)	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
1. Buxheti vjetor publik i alokuar për paga (bruto)	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
2. Buxheti vjetor publik i alokuar për kompjuterizim	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
3. Buxheti publik vjetor i alokuar për shpenzimet e drejtësisë (ekspertizë, interpretim, etj.).	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
4. Buxheti publik vjetor i alokuar për objektet e gjykatave (mirëmbajtja, kostot e funksionimit)	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
5. Buxheti publik vjetor i alokuar për investime në objekte (gjykata) të reja	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
6. Buxheti vjetor publik i alokuar për trajnime	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP
7. Tjetër (ju lutemi specifikoni)	____/ NA / NAP	____/ NA / NAP

Ju lutemi paraqitni ndonjë koment të dobishëm për t'i shpjeguar shifrat e dhëna. Nëse buxheti vjetor publik i realizuar i alokuar për funksionim të të gjitha gjykatave realisht është i ndryshëm nga buxheti vjetor publik i miratuar i alokuar për funksionimin e të gjitha gjykatave, ju lutemi paraqitni arsyet kryesore të diferencave:

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Të dhënat e buxhetit për sistemin gjyqësor, për vitin referues, duhet të paraqiten nën këtë pyetje. Shifra e buxhetit nuk duhet të përfshijë:

- buxhetin e shërbimeve të prokurorisë publike;
- buxhetin për ndihmë juridike;
- buxhetin për sisteme të burgjeve dhe shërbimeve sprovuese;
- buxhetin për funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë;
- buxhetin e mbrojtjes gjyqësore të të rinjve (punëtorëve socialë, etj.);
- buxhetin e Gjykatës Kushtetuese;
- buxhetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Pyetësi kërkon dy lloje të shifrave, që lidhen me buxhetin vjetor publik të gjykatave: buxhetin e aprovuar dhe buxhetin e realizuar. **Buxheti i aprovuar** është buxheti që është miratuar zyrtarisht nga Parlamenti. Nëse buxheti i miratuar ndryshon (ribalancohet ose rishikohet) gjatë vitit, ndryshimi i fundit duhet të raportohet. Buxheti i aprovuar duhet të raportohet, nëse është e mundur, pa burime të tjera (p.sh. pa operacione të bashkë-financuara nga BE-ja). Kjo e fundit duhet të përmendet në komente. **Buxheti i realizuar** korrespondon me shpenzimet e kryera në mënyrë efektive gjatë vitit referues.

Buxheti përfshin 7 nën-kategori. Nën-kategoria 2 është e rëndësishme për këtë pyetje.

1. Pagat (bruto) janë ato të të gjithë personelit gjyqësor dhe jo-gjyqësor që punojnë pranë gjykatave, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, sistemin e prokurorive publike (dhe personelin që punon për shërbimet e

prokurorive). Kjo shumë duhet të përfshijë kostot e pagave totale për punëdhënësin: nëse, përveç pagës bruto të duhur, punëdhënësi gjithashtu paguan sigurime dhe/ose kontribute pensionale, këto kontribute duhet të përfshihen.

2. Kompjuterizimi përfshin të gjitha shpenzimet për pajisjet, investimet, instalimet, përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kompjuterike (përfshirë shpenzimet për stafin teknik të kontraktuar jashtë).

3. Shpenzimet e drejtësisë e bartura nga shteti (ose nga sistemi i drejtësisë) i referohen shumave që gjykatat duhet të paguajnë brenda kornizës së procedurave gjyqësore, të tilla si shpenzime të paguara për opinione të ekspertëve ose interpretë të gjykatave. Duhet të përjashtohen shpenzimet që do të paguheshin në fund nga palët (p.sh. kostot individuale të ekspertëve dhe interpretëve që rimbursohen në buxhetin e gjykatës ose, tarifatat dhe tatimet e gjykatave të paguara për të mbuluar shpenzimet e drejtësisë. As shuma që paguhet për ndihmën juridike nuk duhet të paraqitet këtu (por nën pyetjen 12).


4. Objektet e gjykatave Buxheti përfshin të gjitha kostot që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe funksionimin e objekteve të gjykatave (kostot për qira, energji elektrike, siguri, pastrim, mirëmbajtje, etj.). Ai nuk përfshin investimet në ndërtesat e reja.

5. Përfshin të gjitha kostot që lidhen me investime në ndërtesa të reja gjykatash (ndërtim i strukturës së re ose blerje e objekteve ekzistuese).

6. Buxheti vjetor publik i ndarë për **trajnim** përfshin tërë trajnimin e mbuluar drejtpërdrejt nga gjykatat për trajnimin e gjyqtarëve dhe personelit jo-gjyqësor, duke përjashtuar, nëse është e mundur, sistemin e prokurorive publike. Buxheti specifik i një institucioni të veçantë publik të trajnimit për gjyqtarët dhe/ose prokurorët nuk duhet të raportohet këtu.

7. Të tjera përfshin të gjitha shifrat që nuk mund të përfshihen në kategoritë e listuara më sipër.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin



Buxheti për kompjuterizim është për kompjuterët, pajisjet e tjera të TI-së dhe mirëmbajtje të sistemit të TI-së. Në vitin 2014, të dhënat nuk ishin të disponueshme dhe në vitin 2018 buxheti i miratuar nuk u shpenzua.

Disa burime të jashtme u shpenzuan në fushën e TI-së. Për shembull, projekti SMIL, i cili po zbaton një fazë konsolidimi nga viti 2019 deri në 2021, merr financim nga Shteti i Norvegjisë për një shumë prej 2,528,882.00EUR. Për më tepër, buxheti i projektit NCCR, i financuar nga Bashkimi Evropian, ishte rreth 2.5 milion EUR për 4 vjet (përfshirë pajisjet e TI-së prej rreth 200,000EUR).

Rekomandimi 2: Të mblidhen dhe të raportohen të dhëna të sakta për buxhetet e aprovuara dhe të realizuara, jo vetëm të dhënat zyrtare buxhetore, por edhe financimet e jashtme.

Në vlerësimet e mëparshme ne kemi konstatuar se sistemi gjyqësor në Kosovë, ashtu si vendet/entitetet e tjera fqinje, përfiton nga burime të jashtme shtesë të cilat nuk bëjnë pjesë në buxhetet zyrtare dhe nuk figurojnë në statistika.¹⁰ Shterimi progresiv i tyre në një periudhë afatmesme/afatgjatë duhet të merret parasysh nga autoritetet e Kosovës për të garantuar qëndrueshmërinë e reformave, veçanërisht ato që synojnë futjen në përdorim të mjeteve të TIK-ut në gjyqësor. Në të vërtetë, gjatë ndarjes së burimeve për projektet e bazuara në TI, duhet të merren parasysh të gjitha kostot direkte dhe indirekte të përfshira në aplikimin e teknologjisë së re dhe praktikave të reja profesionale dhe buxheti duhet të jetë i madhësisë sipas ciklit jetësor të projektit, sepse duke nënvlerësuar shumën e parave të kërkuara ka shkaktuar probleme për shumë projekte të TI-së (Udhëzimet për drejtësi kibernetike, § 98, 99).

Ne rekomandojmë që KGJK-ja, KPK-ja dhe institucionet e tjera relevante të përfshira të mbledhin dhe raportojnë të dhëna të sakta mbi buxhetet e miratuara dhe të realizuara gjatë vitit referues për gjykatat dhe prokuroritë. Saktësia e të dhënave është vendimtare për planifikimin efikas dhe identifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Të dhënat mbi kontributet e jashtme gjithashtu duhet të mblidhen dhe të merren parasysh në mënyrë adekuate në kontekstin e planifikimit të politikave në këtë fushë.

¹⁰ Raporti i vlerësimit të thellë të sistemit gjyqësor në Kosovë, <https://rm.coe.int/in-depth-assessment-report-of-the-judicial-system/16807828e6>, Rekomandimet 1 dhe 2; Vlerësimi Krahasues i sistemit gjyqësor nga 2014 në vitin 2017, <https://rm.coe.int/comparative-assessment/1680939684>, f. 10.

Rekomandimi 3: Zhvillimi i një vizioni të përgjithshëm dhe afatgjatë për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë nëpërmjet TI-së, i formuluar me objektiva të qarta, të matshme dhe të verifikueshme, ku teknologjia ofron një mjet dhe jo një qëllim dhe që shkon përtej logjikës së projekteve të izoluar. Kjo do të ndihmojë për të siguruar që ka mbështetje të qëndrueshme financiare për një vendosje dhe përdorim të vazhdueshëm të mjeteve të TI-së.

Paketa e mjeteve të CEPEJ-it 2019 për zbatimin e Udhëzimit të Drejtësisë Kibernetike, shpjegon se qëllimet dhe objektivat duhet të përcaktohen sipas nevojave të forta të qytetarëve dhe përdoruesve, dhe jo sipas teknologjisë. Është thelbësore të prezantohen mjetet e TI-së si një kontribut për një shërbim më të mirë për të gjitha llojet e përdoruesve. Së treti, është e rëndësishme të kemi mbështetje në nivelin më të lartë për të siguruar zbatimin efektiv. Së katërti, duhet të sigurohet pjesëmarrja efektive e grupeve të ndryshme të përdoruesve. Duhet të ketë një mbështetje të qëndrueshme financiare për të mundësuar zbatimin e një vizioni të tillë të përgjithshëm dhe afatgjatë të TI-së.

2.2. Personeli i TI-së në gjykata

I gjithë personeli jo-gjyqtar, që punon në të gjitha gjykatat, duhet të raportohet këtu në ekuivalent me orar të plotë (EOP) për postet realisht të plotësuara. Për të kuptuar më mirë çështjet gjinore në gjyqësor, ju lutemi specifikoni numrin total, si dhe secilën kategori sipas gjinisë. Ju lutemi sigurohuni që shifrat e paraqitura të përjashtojnë stafin që punon për shërbimet e prokurorive publike.

Ka 5 nënkategori të ndryshme. Nën-kategoritë 3 dhe 4 janë të rëndësishme për këtë pyetje. Në vlerësimet e mëparshme, personeli i TI-së u raportua nën nën-kategorinë 4:

52. Numri i personelit jo-gjyqtar që punon në gjykata (nëse është e mundur më 31 dhjetor të vitit referues) (këto të dhëna nuk duhet të përfshijnë personelin që punon për prokurorët publikë; shih pyetjen 60). Nëse të dhënat nuk janë në dispozicion, ju lutem shënojeni NA. Nëse situata nuk është e aplikueshme në Kosovë, ju lutem shënojeni NAP. (ju lutemi jepni informacionin në ekuivalent me orar të plotë dhe për postet e përhershme realisht të plotësuara)

	Total	Burra	Gra
Gjithsej stafi jo-gjyqtar që punon në gjykata (1 + 2 + 3 + 4 + 5)	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___
1. <i>Rechtspfleger</i> (ose organe të ngjashme) me detyra gjyqësore ose kuazi-gjyqësore që kanë kompetencë autonome dhe vendimet e të cilëve mund të jenë subjekt i apelimit	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___
2. Staf i jo-gjyqtar detyra e të cilit është të ndihmojë gjyqtarët siç janë regjistruarit (përgatitja e shkresës së lëndës, ndihma gjatë seancës, incizimi i gjykimit, ndihma në hartimin e vendimeve)	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___
3. Staf i përgjegjës për detyra administrative të ndryshme dhe të menaxhimit të gjykatave (menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i materialeve dhe pajisjeve, përfshirë sistemet kompjuterike, menaxhimin financiar dhe buxhetor, menaxhimin e trajnimit)	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___
4. Staf i teknik	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___
5. Staf tjetër jo-gjyqtar	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___	___/ NA ___ / NAP___

Nëse “stafi tjetër jo-gjyqtar”, ju lutemi specifikoni:

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

3. **Stafi administrativ** nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në ndihmën gjyqësore të një gjyqtari, por janë përgjegjës për detyrat administrative (të tilla si regjistrimi i lëndëve në një sistem kompjuterik, mbikëqyrja e pagimit të tarifave gjyqësore, përgatitja administrative e fajlave të lëndëve, arkivimi) dhe/ose menaxhimi i gjykatës (për shembull një shef i sekretarit të gjykatës, shef i departamentit kompjuterik të gjykatës, drejtor financiar i një gjykate, menaxher i burimeve njerëzore, etj.).

4. **Stafi teknik** përfshin stafin e ngarkuar me detyrat e ekzekutimit ose çdo detyrë teknike dhe të tjera të ndërlidhura me mirëmbajtjen siç janë stafi i pastrimit, stafi i sigurisë, stafi që punon në departamentet kompjuterike të gjykatave ose elektrikistët.

5. **Personeli tjetër jo-gjyqtar** përfshin të gjithë personelin jo-gjyqtar që nuk është përfshirë në kategoritë 1-4.


KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Lidhur me kërkesën për të siguruar numrat e EOP-së

KGJK-ja dhe gjykatat monitorojnë numrin e personelit që është në pushim, meqenëse kjo bëhet manualisht. Prandaj, është sfiduese për ta që të japin numrin e saktë të EOP-së të personelit që realisht punon në gjykata (disa mund të jenë në pushim të lehonisë, pushim mjekësor, etj.). Kërkesat për leje përpunohen me dorë, duke përdorur fletë në formatin Excel dhe formularë në letër. E njëjta vështirësi vërehet edhe për gjyqtarët. Nëse ata shkojnë në pushim më shumë se 30 ditë, ato hiqen manualisht nga sistemi automatik i caktimit të lëndëve.¹¹

Sipas metodologjisë së CEPEJ-it, pushimet nuk hiqen nga EOP dhe as pushimet e rastësishme mjekësore. Vetëm pushimet e rregullta më të gjata të mungesës (si pushimi i lehonisë; pushimet e përhershme për sëmundje, pushimet) dhe orët e rregullta të shkurtuara të punës pavarësisht nga arsyeja nuk duhet të përfshihen nga EOP. Gjyqtarët e deleguar ose të caktuar përkohësisht në funksione të tjera (p.sh. në Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor) (nëse është e aplikueshme dhe nëse nuk kryejnë punë gjyqësore njëkohësisht), nuk duhet të përfshihen në figurën e raportuar. Kjo mund të mos jetë problematike për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve dhe stafit tjetër, por më sfiduese kur EOP nevojitet për ndarjen e punës sipas instancave ose juridiksionit (nëse është e aplikueshme).

11 Kriteret për sistemin automatik të caktimit të lëndëve në gjykatat e Kosovës përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe zbatimi i tyre, janar 2020 (i disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe): https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lqsl/17858_Kriteret_per_shperndarjen_lendeve_ne_gjykatat_Republikes_Kosoves_permes_SMIL_dhe_menyra_zbatimit_tyre.pdf



Në vitin 2020 kishte 17 punëtorë të TI-së. Plani i KGJK-së është që, në vitin 2021, të ketë një zyrtar të TI-së në të gjitha gjykatat themelore dhe gjykatat e degëve. Kjo kërkon rekrutimin e më shumë zyrtarëve të TI-së. Ka gjithashtu personel në gjykata që punon për projektin SMIL (financuar nga Norvegjia). Në vitin 2020 kishte 27 punëtorë prej tyre. Së fundi, që nga shtatori 2017, 50 nëpunës juridikë të përkohshëm (30 në vitin 2021) kanë punuar në gjykata, si pjesë e projektit NCCR (bashkëfinancuar nga BE-ja dhe KGJK-ja), për të digjitalizuar të dhënat e vjetra të dënimeve, duke përmirësuar cilësinë e të dhënave në databazën e NCCR-së, trajnimin dhe mbështetjen e personelit të gjykatave në përdorimin e tij, dhe kryerjen e auditimit të rregullt të sistemit.

Rekomandimi 4: Zhvillimi, dhe mundësisht lidhja me SMIL, i një aplikacioni për burimet njerëzore dhe përditësimi i të dhënave për të mbledhur shifrat e EOP-së dhe për të siguruar një identifikim në kohë të problemeve dhe zbatimin e zgjidhjeve.

Pakoja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për Drejtësi kibernetike shpjegon se një numër i caktuar i mjeteve të TI-së, duke përfshirë një “aplikacion për burimet njerëzore”, janë kritike për funksionimin e gjykatave dhe se pa këto mjete, gjykatat nuk mund të funksionojnë ose do të funksiononin me vështirësi të mëdha.¹² Mbledhja dhe raportimi i numrave të EOP-së është thelbësor sepse shifrat jo-EOP tregojnë një numër më të madh të burimeve njerëzore sesa ai në dispozicion në praktikë.

Rekomandimi 5: Kosova duhet të vazhdojë të investojë në profilet e reja të burimeve njerëzore që janë bërë thelbësore për drejtësinë online (kryesisht duke rekrutuar personel të ri kur trajnimi ose ritrajnimi nuk është i mjaftueshëm).

Udhëzimet e CEPEJ për drejtësi kibernetike të vitit 2016 shpjegojnë se zhvillimi i mjeteve të TI-së në gjykata, dhe në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, kërkon një riinvestim të rëndësishëm në burimet njerëzore përmes rekrutimit ose planeve të trajnimit për shërbimet e reja të propozuara (31 \$), edhe pse kostot për personelin ligjor për gjyqtarë, prokurorë dhe regjistruar, të paktën për momentin, duhet të mbeten të pandryshuara (§ 27).

¹² Shih pakon e mjeteve për mbështetjen e zbatimit të udhëzimeve se si ta thelloni ndryshimin drejt drejtësisë kibernetike, të miratuar në takimin e 32^{te} plenar të CEPEJ, 13-14 qershor 2019, Lista e Aplikacioneve Kompjuterike Kritike, f.16.

PJESA 3 - PËRDORIMI I TI-SË NË GJYKATA

3.1. Përdorimi i TI-së në gjykata gjatë pandemisë

Ky raport fokusohet në përdorimin e TI-së në gjykata në vitin 2020, i cili ishte një vit shumë i veçantë për shkak të krizës pandemike që ka prekur të gjithë botën. Në Kosovë, nga mesi i marsit 2020 deri në fillim të qershorit 2020, gjykatat u mbyllën pothuajse plotësisht: ato u morën vetëm me çështje urgjente, të tilla si masat e paraburgimit, rastet e dhunës në familje.¹³ Nga 1 qershori, gjykatat filluan të punojnë përsëri plotësisht dhe seancat u mbajtën zakonisht, së pari pa prezencën e publikut (vetëm vëzhguesit nga organizatat e shoqërisë civile, nga EULEX-i dhe OSBE-ja) dhe më pas, gradualisht, me prezencë të kufizuar të publikut.¹⁴ Aktualisht prania e publikut mbetet e kufizuar, pasi duhet të ketë distancë të mjaftueshme në sallat e gjyqit mes njerëzve. Është në diskrecionin e gjyqtarit të lejojë ose refuzojë kërkesat e individëve për të marrë pjesë në seancë.

Gjatë këtyre dy muajve të gjysmë, disa praktika të reja u zbatuan në gjykata, duke përdorur mjete elektronike. Për shembull, një numër i vogël seancash u mbajtën në internet, me mbështetjen e projektit të financuar nga USAID, Programi i zhvillimit të sistemit të drejtësisë (PFSD). Dhjetë (10) seanca online u mbajtën në Gjykatën Themelore të Prishtinës, katër (4) në Gjykatën Themelore të Prizrenit, dhe katër (4) në zonën e Pejës. Gjykata Themelore në Gjiçan shpjegoi se ata nuk kishin pajisje për të zhvilluar seanca online. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, disa gjyqtarë pranuan disa kërkesa dhe fajla të paraqitura me email nga palët, dhe disa ftesa u janë dërguar nga gjykatat avokatëve në mënyrë elektronike. Megjithatë, kjo ndodhi në një bazë ad hoc dhe në një shkallë të vogël.¹⁵

Gjatë shpërthimit të pandemisë COVID-19, teknologjitë e informacionit kanë demonstruar potencialin për të mbështetur funksionimin e sistemeve gjyqësore duke mundësuar një përshtatje të shpejtë me nevojat dhe sfidat e reja. Paraqitja e lëndëve elektronike, komunikimi elektronik ligjërishit i vlefshëm midis palëve, autoriteteve publike dhe gjykatave dhe video-konferencat janë shembuj të këtij potenciali. Ky raport gjithashtu synon të inkurajojë palët e interesit të përfitojnë nga ato praktika të reja dhe të rishqyrtojnë disa aspekte të funksionimit tradicional të gjykatave.

Kalimi nga një përdorim ad hoc i mjeteve të tilla në disponueshmërinë e tyre të përhapur dhe përdorimin më sistematik do të kërkojë futjen e ndryshimeve në kuadrin rregullativ dhe praktikën organizative. Në fund të vitit 2020, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Oda e Avokatëve filluan të diskutojnë mbi mundësinë e përdorimit të thirrjeve elektronike, të cilat do të lehtësonin komunikimin midis gjykatave dhe avokatëve. Transmetimi i thirrjeve me mjete elektronike, si dhe përdorimi i komunikimit elektronik midis gjykatave dhe avokatëve janë disa nga fushat e hetuara nga pyetësi i CEPEJ për TI. Këto fusha do të diskutohen më poshtë, duke ndjekur rendin e pyetjeve në pyetësin e CEPEJ për TI.

3.2. Vlerësimi i ndikimit të projekteve të TI-së

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të TI-së në punën e gjykatave është një komponent i rëndësishëm i qëllimit të përgjithshëm të përfitimeve të efikasitetit dhe efektivitetit që rrjedhin nga përdorimi i TI-së në sistemet gjyqësore.

65-4 A e keni matur ndikimin që rezultojnë nga zbatimi i një ose disa komponentëve të sistemit tuaj të ri të informacionit?

Po ☐ Jo ☐

13 Së pari, më 12 mars, KGJK-ja vendosi mbylljen e gjykatave për publikun, por më pas më 16 mars, KGJK-ja vendosi të zvogëlojë aktivitetet e gjykatave në minimum: duheshin trajtuar vetëm çështjet urgjente, siç janë masat e paraburgimit, rastet e dhunës në familje. Vendimet e KGJK-së 53/2020 dhe 53/2020 të datës 12 dhe 15 mars 2020 (vetëm në gjuhën shqipe).

14 Vendimi i KGJK-së 85/2020 i 29 majit 2020 (vetëm në gjuhën shqipe).

15 Shih edhe Raportin Special të EULEX-it (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë) mbi Ndikimin e COVID-19 në Sundimin e Ligjit në Kosovë, Vlerësimi dhe rekomandimet për periudhën mars 2020 - mars 2021, nxjerrë në maj 2021, mbi Përdorimin e video-telekonferencës (VTK), faqe 15 ("gjykatat kryesisht e kanë kufizuar përdorimin e seancave në internet në lëndët civile, ndërsa ato kanë qenë ngurruese për të përdorur mjetet e VTK-së në lëndët penale për shkak të mungesës së mjeteve teknologjike dhe gjithashtu për shkak të shqetësimeve në lidhje me privatësinë ose integritetin e sesioneve në internet ... si dhe administrimin e provave në seancat online").

65.4.1 Nëse po, a e keni matur ndikimin në: (shumë përgjigje të mundshme)

- ☐ Procesi biznesi
- ☐ Ngarkesa pune
- ☐ Burime njerëzore
- ☐ Kosto
- ☐ Tjetër, ju lutemi specifikoni -----

Komente (ju lutemi, specifikoni shembuj të ndikimit)

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 65-4 eksploron nëse ka pasur një vlerësim të ndikimit (pozitiv apo negativ) të sistemit të ri të informacionit në punën e gjykatave. Përgjigja duhet të jetë “Po” si kur vlerësimi bëhet drejtpërdrejt nga gjykatat, ashtu edhe kur kontrahetohet nga kontraktorët e jashtëm. Nëse një vlerësim i tillë i ndikimit ka ndodhur (përgjigja “Po”) pjesa e dytë e pyetjes synon të rishikojë elementët e ndryshëm kundër të cilëve është matur ndikimi:

- Proceset e biznesit nënkupton matjen e ndikimit të sistemit të ri në shërbime të caktuara në gjykata. Për shembull, kur paraqitja elektronike e dokumenteve është vënë në praktikë përmes sistemit të TI-së, mund të matet ndikimi (pozitiv ose negativ) në kohën e dorëzimit të dokumenteve, ose në numrin e kopjeve që do të krijohen dhe dorëzohen tek palët e ndryshme.
- Ngarkesa e punës - në lidhje me të njëjtin shembull, mund të matet ndikimi në ngarkesën e punës të kategorive të ndryshme të stafit të gjykatave (gjyqtarë, staf gjyqësor jo gjyqtarë).
- Burimet njerëzore - vlerësimi do të shqyrtonte nëse sistemi i ri ka ndikim në numrin e personelit të gjykatës që kërkohet për të ofruar të njëjtin shërbim.
- Kostot - vlerësimi mund të thellohet nëse sistemi i ri rrit/ul kostot në lidhje me të njëjtat shërbime para dhe pas zbatimit.

Komente duhet të përfshijë shembuj konkretë të vlerësimeve të tilla të ndikimit (nëse ka) dhe referenca në dokumentet përkatëse (vlerësim, studime ose raporte zyrtare)

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Projekti SMIL filloi në vitin 2014 dhe po financohet nga Norvegjia. Aktualisht është në fazën e konsolidimit deri në vitin 2021. Që nga janari 2018, ai u vendos gradualisht dhe u zbatua në të gjitha gjykatat. Në vitin 2020 SMIL u vendos dhe u zbatua në të gjitha gjykatat themelore, për të gjitha llojet e lëndëve, përveç në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, ku zbatimi është ende në proces. Ndikimi që rezulton nga zbatimi i këtij sistemi të ri në punën e gjykatave themelore deri më tani nuk është vlerësuar.

Rekomandimi 6: Në përputhje me pakon e mjeteve të CEPEJ për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike, ndikimi i projekteve të TI-së duhet të vlerësohet gjatë zbatimit të projektit dhe/ose pas përfundimit të tij. Duhet të kryhet një anketë e kënaqshmërisë së përdoruesve në SMIL e cila duhet të përfshijë gjyqtarë, prokurorë dhe staf në gjykata dhe prokurori.

Pakoja e mjeteve të CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike propozon një rrjet për vlerësimin e projekteve të TI-së. Një nga hapat që duhet ndërmarrë është kryerja e një vlerësimi të ndikimit të projektit të kryer gjatë zbatimit të projektit ose pas përfundimit të tij, dhe shqyrtimi i rezultateve të tij.¹⁶

Udhëzimet sugjerojnë më tej përfshirjen e ekspertëve ose studiuesve të pavarur nga një gamë e gjerë disiplinash në një ushtrim të tillë (Udhëzimet, § 120). Nga njëra anë, kjo u mundëson organizatave të kenë qasje në ekspertizën që normalisht nuk është në dispozicion të tyre (sociologjia, menaxhimi, psikologjia sociale, ekonometria, antropologjia, etj.), dhe nga ana tjetër ndihmon në sigurimin e paanësisë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave kundrejt përdoruesve dhe publikut.

3.3. Siguria e sistemit të informacionit të gjykata dhe mbrojtja e të dhënave

Grupi i pyetjeve në këtë pjesë shqyrton mekanizmat ekzistues që synojnë të sigurojnë sigurinë e informacionit dhe të dhënave të mbledhura, të ruajtura dhe të trajtuara nga gjyqësori. Pyetjet trajtojnë ekzistencën e mekanizmave të kontrollit/auditimit në praktikë dhe mbrojtjen e informacionit dhe të dhënave gjyqësore në legjislacion.

¹⁶ Shih pakon e mjeteve për mbështetjen e zbatimit të udhëzimeve se si ta thelloni ndryshimin drejt drejtësisë kibernetike, të miratuar në takimin e 32^{te} plenar të CEPEJ, 13-14 qershor 2019, Vegla #5 - Tabela e sugjeruar për vlerësimin e projekteve të TI-së, f.46.

65-5 A ka auditime të pavarura ose mekanizma të tjerë për të kontribuar në politikën globale të sigurisë lidhur me sistemin e informacionit e gjyqësorit?

Po ☐ Jo ☐

Komente (ju lutemi specifikoni veçanërisht nëse ekzistojnë kornizat nacionale të sigurisë së informacionit):

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 65-5 fokusohet në auditime të pavarura ose mekanizma të tjerë të kryer nga specialistë të jashtëm të sigurisë së TI-së, duke vlerësuar sistemin e sigurisë në gjyqësor.

Komentet duhet të specifikojnë karakteristikat (të tilla si përbërja, periodiciteti dhe lloji i kompetencave - rekomandimet dhe/ose vendimet detyruese) të mekanizmave të tillë që vlerësojnë sigurinë e informacionit në gjyqësor dhe, aty ku është e mundur, të përfshijnë shembuj konkretë të këtyre auditimeve me referenca në dokumentet/raportet përkatëse.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike: <http://www.zka-rks.org/en/>. Një raport auditimi i teknologjisë së informacionit në lidhje me SMIL është bërë nga Zyra Kombëtare e Auditimit në qershor 2021.¹⁷

Rekomandimi 7: *Sigurimi i sigurisë së të dhënave është një shqetësim kryesor në zbatimin e mjeteve të TI-së në gjyqësor. Nevojitet një politikë sigurie në lidhje me të dhënat gjyqësore, e cila duhet të artikulojë qartë parimet që duhet të informojnë ruajtjen, pronësinë, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave gjyqësore, me synim menaxhimin e rreziqeve dhe jo shmangien e tyre.*

Pakoja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike sugjeron një qasje pragmatike gjatë trajtimit të çështjeve të sigurisë në kontekstin e sistemeve të informacionit, e cila informohet me fleksibilitet. Një fleksibilitet i tillë qëndron në artikullimin e një politike të qartë që kërkon të menaxhojë rreziqet në vend që t'i shmangë ato, dhe zbatimin e analizave periodike të rrezikut. Analiza të tilla janë të nevojshme për të gjitha aplikacionet kompjuterike (përfshirë mënyrën në të cilën menaxhohen aplikacionet dhe pajisjet kompjuterike) me rreziqe që vlerësohen si nga këndvështrimi i mundësisë së shfaqjes ashtu edhe nga shkalla e dëmtimit në rast të shfaqjes.

65-6 A sigurohet në nivel legjislativ mbrojtja e të dhënave personale e menaxhuar nga gjykatat?

Po ☐ Jo ☐

Koment: Nëse po, ju lutemi specifikoni ndër të tjera:

- nëse ka autoritete specifikisht përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale
- shtrirja e të drejtave të dhëna qytetarëve në kornizën specifike të softuerit të përdorur nga gjykatat
- nëse ka kontrole ose kufizime me ligj lidhur me ndarjen e databazave të menaxhuara nga gjykatat me administratat e tjera (policinë, etj.)

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 65-6 eksploron nëse përdorimi i të dhënave personale të menaxhuara nga gjykatat është i rregulluar me legjislacion specifik. Nëse përgjigja është “Po” informacion shtesë duhet të jepet në kutinë e komenteve.

Komente së pari duhet të specifikojë referencat ligjore në lidhje me përdorimin e të dhënave personale të menaxhuara nga gjykatat. Ato gjithashtu duhet të përfshijnë informacion nëse ligji parashikon kontrole ose

¹⁷ https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/06/SMIL_2021_Shqip.pdf

kufizime në lidhje me ndarjen e databazave të menaxhuara nga gjykatat me administratat e tjera (policia, etj.). Komentet gjithashtu duhet të shpjegojnë se cilat autoritete (nëse ka) janë veçanërisht përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale të menaxhuara nga gjykatat. Aty ku qytetarët mund të kenë qasje në informacionin gjyqësor në mënyrë elektronike, shtrirja e të drejtave të tyre duhet të shpjegohet dhe shembujt duhet të jepen aty ku është e mundur.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>). Ai krijon një institucion përgjegjës për monitorimin e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave, Agjencisë së Informimit dhe Privatësisë: <https://aip.rks-gov.net/en/>. Ai gjithashtu ofron këshilla për organet publike dhe private për çështje që lidhen me mbrojtjen e të dhënave.¹⁸ Megjithatë, ligji nuk është i qartë për të dhënat personale të menaxhuara nga gjykatat.

Rekomandimi 8: Duhet të miratohen rregulla të qarta që përcaktojnë të drejtat e qasjes në dokument, si për përdoruesit në sistemin e drejtësisë ashtu edhe për palët e jashtme në përputhje me të drejtat e privatësisë.

Pakoja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike nxjerr në pah balancën delikate që duhet të arrihet midis nevojës për anonimizim të të dhënave në dokumentet e vëna në dispozicion të publikut (për arsye të mbrojtjes së të dhënave personale) dhe parimit të drejtësisë së hapur. Prandaj, rregullat e qarta duhet të zhvillohen (dhe zbatohen) të cilat përcaktojnë të drejtat e qasjes në dokumente, si për përdoruesit në sistemin e drejtësisë ashtu edhe për palët e jashtme, mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion dhe autoritetin përgjegjës.

3.4. Databaza të centralizuara për mbështetje të vendimeve

Grupi i pyetjeve në këtë seksion synon të mbledhë informacion mbi disponueshmërinë, gjerësinë e qasshmërisë, përmbajtjen dhe përdoruesit e databazave gjyqësore, të tilla si databazat e praktikës gjyqësore ose të dënimeve penale.

3.4.1. Databaza nacionale e centralizuar e vendimeve të gjykatave (praktika gjyqësore, etj.)

62.4.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Për vendime të instancës së parë</i>	<i>Për vendime të instancës së dytë</i>	<i>Për vendimet e instancës së tretë</i>	<i>Lidhja me praktika gjyqësore të KED-Nj-së</i>	<i>Të dhëna anonime</i>	<i>Databazë e praktikave gjyqësore në dispozicion gratis në internet</i>	<i>Databazë e praktikave gjyqësore në dispozicion në të dhëna të hapura</i>
Civile dhe/ose ekonomike	○ Po, të gjitha aktgjykimet ○ Po, disa aktgjykime ○ Jo	○ Po, të gjitha aktgjykimet ○ Po, disa aktgjykime ○ Jo	○ Po, të gjitha aktgjykimet ○ Po, disa aktgjykime ○ Jo	Po Jo	Po Jo	Po Jo	Po Jo

¹⁸ Agjencia e Informimit dhe Privatësisë (Këshilla AIP): <https://aip.rks-gov.net/keshillat-e-aip/keshillat-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/>

Penale	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	Po Jo	Po Jo	Po Jo	Po Jo
Administrative	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	Po Jo	Po Jo	Po Jo	Po Jo

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 62-4 shqyrton disponueshmërinë e databazës nacionale të centralizuar të vendimeve të gjykatave (databaza e praktikës gjyqësore). Përgjigja duhet të jetë “Po” në rast se një databazë e tillë ekziston pavarësisht nga forma e saj elektronike dhe lloji i lëndëve të mbuluara, sipas kategorisë ose instancës së lëndëve. Informacioni në këtë drejtim më vonë mund të sigurohet në pjesën e dytë të pyetjes, e cila eksploron përmbajtjen dhe veçoritë teknike të databazës, dhe në kutinë e komenteve.

Vendimet sipas instancës: për të vlerësuar fushëveprimin e databazës së praktikës gjyqësore, tabela në këtë pyetje përfshin kolona të veçanta për secilën instancë të vendimeve dhe hetimeve gjyqësore nëse të gjitha vendimet e marra në instancën përkatëse përfshihen në databazën ose vetëm (ato të zgjedhura si) më relevante.

Lidhja me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj): opsioni “Po” duhet të zgjidhet nëse vendimet e regjistruara në databazën e praktikës gjyqësore përmbajnë vegëza të cilat i referohen aktgjykimeve të GjEDNj-së në databazën HUDOC.


Disponueshmëria e lirë në internet dhe të dhënat e hapura: “të dhënat e hapura” i referohen vënies në dispozicion të databazave të strukturuar për shkarkim publik. Këto të dhëna mund të ripërdoren lirë në varësi të kushteve të një licence të veçantë, e cila në veçanti mund të përcaktojë ose ndalojë qëllime të caktuara të ripërdorimit (shih “Kartën Etike Evropiane të CEPEJ mbi përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemet gjyqësore dhe të mjedisit të tyre). Të dhënat e hapura nuk duhet të ngatërrohen me informacionin publik unitar të disponueshëm në uebsajte, ku e gjithë databaza nuk mund të shkarkohet (për shembull, databaza e vendimeve gjyqësore).

Komente mund të shtohet për të sqaruar veçoritë e tjera të databazës, të tilla si:

- nëse publikimit të këtyre vendimeve i paraprin (ose jo) një anonimizimi të emrit të palëve, të dëshmitarëve dhe/ose profesionistëve (gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, etj.);
- nëse të dhënat e publikuara përpunohen nga operatorë publikë ose privatë (iniciativë);
- nëse të dhënat e publikuara përpunohen me sisteme ekspertësh ose inteligjencë artificiale (për drejtësinë parashikuese për shembull);
- masën në të cilën databaza përdoret dhe/ose konsiderohet një mjet i dobishëm për mbështetjen e vendimeve;
- nëse zgjidhet “po për disa aktgjykime”, cilat janë kriteret për publikimin e vendimeve në databazë.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Një numër i caktuar aktgjykimesh nga të gjitha gjykatat themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme janë në dispozicion të publikut në uebsajtin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (rreth 40000 aktgjykime).¹⁹ Publikohen vetëm aktgjykime përfundimtare. Emrat e palëve janë anonimizuar, bazuar në Udhëzimin Administrativ të KGJK-së të datës 2 shkurt 2016.²⁰ Procesi i anonimizimit bëhet manualisht nga stafi i gjykatës. Sipas këtij udhëzimi, është e rëndësishme të rritet qasja e publikut në aktgjykime dhe të rritet transparenca e gjyqësorit.



Është e mundur të gesh një rast specifik duke futur numrin e saktë të rastit, ose të bësh një kërkim nga gjykata, sipas llojit të aktgjykimit (lëndët penale, lëndët civile, lëndët administrative, etj.), nga gjyqtari, për një periudhë të caktuar kohore, dhe/ose duke përdorur një fjalë kyçe:

¹⁹ <https://www.gjyqesori-rks.org/?lang=en>.

²⁰ <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/Udhezim%20Administrativ%20per%20anonimizimin%20dhe%20publikimin%20e%20aktgjykimeve%20te%20plotfuqishme.pdf>

Judgements

Court

[Choose]

Branch

[Choose]

Type of Judgement

[Choose]

From

To

Judge

[Choose]

Case Number

Keyword

Search

Ndërsa kjo mund të jetë e dobishme për publikun e gjerë, gjyqtarët e intervistuar shpjeguan se ky mjet nuk i ndihmon veçanërisht në punën e tyre të përditshme gjatë hartimit të aktgjyqimeve sepse ata nuk janë në gjendje të kryejnë një kontroll të saktë. Shumica prej tyre thanë se rrallë e përdorin këtë databazë, ose e përdorin atë për të gjetur një aktgjykim pasi diskutojnë me kolegë për të identifikuar se cili gjyqtar në Kosovë kishte një lëndë të ngjashme dhe kur përafërsisht.

Për më tepër, Gjykata Supreme, në Ligjin për Gjykatat, ka përgjegjësinë të “nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat” (Neni 26 (1.4)). Disa mendime juridike janë në dispozicion në uebsajtin e gjykatës.²¹ Gjithashtu, Gjykata Supreme, me mbështetjen financiare të donatorëve të jashtëm, përdori për të publikuar Buletinet e praktikave gjyqësore. Këto janë në dispozicion në uebsajtin zyrtar të Gjykatës Supreme. Sidoqoftë, buletini nuk u publikua mes viteve 2016 dhe 2019:²²

Search with

SQ

SR

EN

Case Law Bulletin

2019

2016

2015

2011

2008

Gjyqtarët e intervistuar shpjeguan se buletinet ishin të dobishme. Megjithatë, vetëm një numër i vogël lëndësh arrijnë në Gjykatën Supreme. Prandaj, vetëm një numër i vogël çështjesh mund të trajtohen nga Gjykata Supreme çdo vit. Për më tepër, buletini nuk mundësonte kryerjen e një kërkimi të saktë.

21 <https://supreme.gjyqesori-rks.org/mendimet-juridike/>

22 <https://supreme.gjyqesori-rks.org/buletinet/>

Rekomandimi 9: *Përmirësimi i funksionalitetit e databazës ekzistuese të vendimeve gjyqësore, në përputhje me nevojat e përdoruesve, për të siguruar sigurinë juridike, parashikueshmërinë dhe cilësinë e aktgjykimeve.*

Teknologji të tilla si databazat elektronike të praktikës gjyqësore kontribuojnë në rezultate më të drejta, më të barabarta dhe më të parashikueshme. Databaza legjislative dhe e praktikës gjyqësore lehtëson kërkimet nëpër organet e ligjit dhe u vënë në dispozicion një sasi më të madhe të dhënash praktikuesve. Këto mjete ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë juridike, si dhe parashikueshmërinë dhe cilësinë e aktgjykimeve të dhëna, pasi i pajisin gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët më mirë për punën e tyre. Aty ku vendimet janë të parashikueshme, qytetarët kanë një ndjenjë më të mirë se rastet trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykatat.

Disa vende në Evropë tashmë kanë vendosur databaza publike plotësisht funksionale, për shembull, në Francë, JuriCA, JuriNET dhe Legifrance. Në disa vende, zhvillimi i databazave pretendohet se ka ndihmuar në ndryshimin e arsyetimit ligjor të praktikuesve, argumentimi i të cilëve është më pak i bazuar në parime dhe më shumë i bazuar në raste, si rezultat i bollëkut të referencave ndaj aktgjykimeve të kaluara. Baza ekzistuese e të dhënave të vendimeve gjyqësore të publikuara në portalin e gjyqësorit në Kosovë mund të përmirësohet duke zgjeruar funksionalitetet e SMIL-it dhe duke krijuar një lidhje ndërmjet SMIL-it dhe kësaj baze të të dhënave për ta popolluar atë në mënyrë automatike me vendimet gjyqësore të vendosura në SMIL.

3.4.2. Një regjistër penal nacional i kompjuterizuar që i centralizon të gjitha dënimet penale

62-6 A ka një regjistër penal nacional të kompjuterizuar që i centralizon të gjitha dënimet penale?

Po ☐ Jo ☐

62.6.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

- ☐ Lidhja me regjistra penale të tjerë evropian të së njëjtës natyrë
- ☐ Përmbajtja drejtpërdrejt në dispozicion përmes mjeteve të kompjuterizuara për gjyqtarë dhe/ose prokurorë
- ☐ Përmbajtja drejtpërdrejt në dispozicion për qëllime jo penale (çështje të tjera civile dhe administrative)

Koment - Ju lutemi specifikoni se cili është autoriteti që e lejon qasjen

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 62-6 fokusohet vetëm në ekzistencën e databazave/regjistrave për dënimet penale dhe nëse përmbajtja e këtyre të dhënave është në dispozicion të profesionistëve gjyqësorë. Detajet e kërkuara në pjesën e dytë të pyetjes synojnë të eksplorojnë nivelin e lidhjes së kësaj databaze me të regjistrat e ngjashëm evropian dhe qasshmërinë e saj elektronike tek profesionistët gjyqësorë për qëllime penale dhe të tjera nga ato penale.

Komente mund të shtohet për të shpjeguar dhe sqaruar aspekte të tjera të regjistrit kombëtar të dënimeve penale, siç është autoriteti që menaxhon dhe siguron qasje në procesverbal, ose kushte/kufizime të tjera të qasjes që zbatohen në praktikë.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Projekti i Regjistrave Kombëtarë të Centralizuar Penal (NCCR) vitet e fundit, ka punuar në krijimin e një regjistri të centralizuar të kompjuterizuar të dënimeve penale. Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian. Në fund të vitit 2020, kjo databazë u përfundua, por puna për rirregullimin e databazës dhe pastrimin e të dhënave vazhdon. Gjithashtu vazhdon puna për krijimin e sistemit të NCCR-së, i cili përfshin shumë elementë të tjerë, ndër të cilët struktura administrative dhe korniza rregullative.

Në vitin 2020, gjyqtarët e intervistuar (duke punuar në çështjet penale) shpjeguan se përmbajtja e bazës së të dhënave të NCCR nuk ishte drejtpërdrejt e disponueshme përmes mjeteve të kompjuterizuara. Megjithatë, zyrat e gjendjes civile në gjykata filluan të përdorin bazën e të dhënave NCCR në vitin 2020 për përgatitjen e certifikatave të dosjeve penale, pasi kjo konsiderohet më e sakta ndër bazat ekzistuese të të dhënave dhe e vetmja që është e centralizuar. Prandaj, edhe pse gjyqtarët nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në KKKR, ata kanë akses nëpërmjet stafit të gjykatës me paraqitjen e një kërkesë.

Konsultimet e mëtejshme me ekipin e NCCR-së u zhvilluan pas seminarit të 21 tetorit 2021. Ekipi i NCCR-së shpjegoi se së shpejti do t'u sigurohet akses direkt gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe se trajnimi në këtë drejtim do të fillojë së shpejti. KGJK është ende duke e diskutuar këtë çështje. Në sistemin NCCR janë ndërtuar veçori për të parandaluar abuzimet, p.sh., duke regjistruar çdo akses në sistem.

Disa gjyqtarë të intervistuar shpjeguan se ata ndonjëherë përdorin SMIL për të parë nëse një i pandehur ishte dënuar në të kaluarën. Megjithatë, ata mund të kenë akses në të dhëna të kufizuara dhe nuk mund t'i qasen vetë gjykimit.

Rekomandimi 10: *Përmirësimi i funksionalitetit dhe sigurimi i qasjes në NCCR për gjyqtarë dhe/ose prokurorë si mjet mbështetës vendimesh, siç parashikohet aktualisht nga ekipi i NCCR-së.*

3.5. Mjete ndihmëse shkrimi

Grupi i pyetjeve në këtë seksion synon të mbledhë informacion mbi disponueshmërinë dhe përdorimin e mjeteve ndihmëse shkrimi në lidhje me përmbajtjen e vendimeve ose akteve të tjera (të tilla si shabllonet, paragrafët e shkruar paraprakisht) dhe instrumentet e incizimit të zërit.

3.5.1. Mjetet ndihmëse shkrimi, siç janë modelet e shablloneve

62-7 A ka mjete ndihmëse shkrimi për të cilën përmbajtja bashkërendohet në nivel nacional? (modele ose shabllone, paragrafë tanimë të para-shkruar, etj.)

Po ☐ Jo ☐

62.7.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 62-7 vlerëson shkallën e disponueshmërisë së mjeteve ndihmëse shkrimi, përmbajtja e të cilave është e koordinuar në nivel kombëtar. Pyetja synon të identifikojë modele dhe shabllone, të cilat janë zhvilluar për përdorim në nivel kombëtar, p.sh., nga një grup punues kombëtar praktikuesish, dhe jo nisma të izoluara vendore ose individuale të një gjykate (p.sh.: krijimi nga një magjistrat i paragrafëve model në një përpunues teksti për vendimet e gjykatës; procesverbali i seancës; thirrjet dhe dokumentet e tjera standarde).

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse të gjitha shabllonet janë të disponueshme për të gjitha gjykatat për një çështje specifike (civile, ekonomike, penale, administrative);
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse shumica e shablloneve janë të disponueshme për të gjitha gjykatat ose të gjitha shabllonet për shumicën e gjykatave;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse disa nga shabllonet janë të disponueshme për shumicën e gjykatave ose shumica e shablloneve për disa gjykata;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse shabllonet sapo kanë filluar të jenë të disponueshme ose janë në fazë testimi;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse shabllonet nuk ekzistojnë fare për çështjen specifike;
- NA duhet të zgjidhet nëse ekzistojnë mjete ndihmëse shkrimi, por informacioni specifik nuk është i disponueshëm.

Komente mund të përmbajë informacion shtesë për të dhënë kontekst për disa nga përgjigjet e dhëna në tabelë (p.sh., nëse shabllonet janë në fazë testimi; shembuj të mjeteve ndihmëse shkrimi që përdoren).

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Ekzistojnë shabllone për vendime dhe aktgjykime në të gjitha llojet e lëndëve, të cilat janë të disponueshme në Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL). Shabllonet japin paragrafin e parë në fillim të vendimit ose aktgjykimit me informacionin bazë për lëndën, si: emri i gjyqtarit, të dhënat në lidhje me palët, data e vendimit/aktgjykimit, numri i lëndës në SMIL. Ky informacion gjenerohet automatikisht nga SMIL. Shabllonet nuk japin udhëzime të mëtejshme.

Gjyqtarët e intervistuar shpjeguan se shabllonet në SMIL nuk janë veçanërisht të dobishme, pasi ato japin vetëm paragrafin e parë të vendimit/aktgjykimit. Prandaj, gjyqtarët vazhdojnë të përgatisin vendimet/aktgjykimet duke përdorur shabllonet e tyre dhe pastaj t'i kopjojnë dhe vendosin ato në shabllonin në SMIL.

Rekomandimi 11: *Teknologjitë e mbështetjes së vendimeve të tilla si mjetet ndihmëse shkrimi sigurojnë koherencë dhe ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë në dhënien e aktgjykimeve. Shabllonet ekzistuese në SMIL duhet të përmirësohen, për të pasqyruar nevojat e përdoruesve dhe, aty ku është e mundur, të bazohen në përvojën e zhvilluar në praktikë (duke përfshirë mbështetjen në gjykimet në SMIL në raste të ngjashme). KGJK-ja duhet të marrë drejtimin në këtë proces.*

3.5.2. Mjetet e incizimit të zërit

62-8 A ka mjete për incizim zëri?

Po ☐ Jo ☐

62.8.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni:

	<i>Disponueshmëria e mjeteve të thjeshta diktimi</i>	<i>Disponueshmëria e mjeteve për incizimin e shumë folësve</i>	<i>Veçoria e njohjes së zërit</i>
Civile dhe/ose ekonomike	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose vetëm në disa faza pilot ○ jo të disponueshme për këtë çështje	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose në disa faza pilot ○ jo të disponueshme për këtë çështje	○ Po ○ Testim pilot ○ Jo
Penale	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose vetëm në disa faza pilot ○ jo të disponueshme për këtë çështje	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose në disa faza pilot ○ jo të disponueshme për këtë çështje	○ Po ○ Testim pilot ○ Jo
Administrative	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose vetëm në disa faza pilot ○ jo të disponueshme për këtë çështje	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose në disa faza pilot ○ jo të disponueshme për këtë çështje	○ Po ○ Testim pilot ○ Jo

Koment

Informacioni përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 62-8 vlerëson disponueshmërinë e mjeteve të incizimit të zërit në gjykata.

Mjetet e incizimit të zërit përfshijnë softuer dhe harduer të ndryshme të përdorura në seanca ose si pjesë e procedurave gjyqësore me ose pa veçori të njohjes së zërit të kompjuterit.

Mjete të thjeshta diktimi përfshijnë për shembull incizues (portativ) të cilët mund të përdoren nga gjyqtarët për të diktuar vendimet që do të shtypen më vonë nga stafi i gjykatës.

Mjete incizimi të shumë folësve janë një shembull më i sofistikuar i instrumenteve të incizimit të zërit. Sistemet e audio-incizimit me shumë kanale janë përgjithësisht të disponueshme në sallat e gjyqit dhe mundësojnë incizimin, përmes mikrofonave të shumtë, gjyqtarëve, palëve dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë gjatë seancave.

Veçoria e njohjes së zërit është një mjet që përdor zërin e incizuar, identifikon automatikisht fjalët dhe e trans-

formon atë në një dokument teksti. Ky dokument mund të redaktohet më vonë nga stafi i gjykatës.

Në dritën e përkufizimeve të dhëna, nëse ekziston një mjet i thjeshtë i diktimit të zërit i përdorur nga të gjithë gjyqtarët në të gjitha gjykatat e shkallës së parë, përveç çështjeve administrative, pa veçori të njohjes së zërit, përgjigjet mund të jenë përkatësisht: “i disponueshëm në shumicën e gjykatave”, “jo i disponueshëm për këtë çështje”, “Jo”.

Komente mund të përmbajë informacion shtesë për të siguruar kontekst për disa nga përgjigjet e dhëna në tabelë. Për shembull, në lidhje me shembullin e mësipërm, përgjigja “i disponueshëm në shumicën e gjykatave” mund të sqarohet më tej në komentet duke specifikuar se mjeti është i disponueshëm për të gjithë gjyqtarët në të gjitha gjykatat e shkallës së parë, por jo në gjykatat e tjera. Gjithashtu, nëse zgjidhet “Testimi pilot”, informacione shtesë mund të shtohen në komente për të sqaruar fushëveprimin gjeografik, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e fazës së testimit.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Mjetet e incizimit të zërit duhet të dallohen nga përdorimi i mjeteve të video-konferencës dhe incizimit të përmendura më poshtë nën 3.6.7 dhe 3.6.8 (pyetjet 64-10 dhe 64-11).

Mjetet e incizimit të zërit nuk janë të disponueshme në gjykata. Nuk ka mjete diktimi ose mjete incizim të shumë folësve.

3.5.3. Sajti i intranetit

62-9 A ka faqe intraneti brenda sistemit gjyqësor për shpërndarjen e lajmeve/risive?

Norma e disponueshmërisë:

- 100% - e qasshme për të gjithë në gjyqësor
- 50-99% - e qasshme për shumicën e gjyqtarëve/prokurorëve në të gjitha instancat
- 10-49% - vetëm në disa gjykata
- 1-9% - vetëm në një gjykatë
- 0% - Pa qasje
- NA

Komente - pyetjet 62.1 deri në 62.10

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 62-9 i referohet qasjes së gjyqtarëve dhe të gjithë personelit tjetër të gjykatave në një rrjet të brendshëm interneti ku informacioni kombëtar ose lokal u vihet në dispozicion. Qëllimi i një sajti intraneti është për t'u siguruar personave që kanë qasje në të informacionin, burimet dhe mjetet e bashkëpunimit që u nevojiten për të kryer më mirë detyrat e tyre. Sajti i intranetit mund të mundësojë qasje, për shembull, në të gjitha ligjet e reja, procedurat e reja, manualët ose udhëzimet e tjera dhe/ose shpërndarjen e informacionit të ngjashëm.

Indikacionet në lidhje me normat e ndryshme të disponueshmërisë jepen në tekstin e pyetjes.

Komente mund të përfshijë informacion shtesë për t'i dhënë kontekst përgjigjes në lidhje me normën e disponueshmërisë, siç janë: gjykatat ku ky mjet është në dispozicion; kategoritë e stafit të gjykatave (përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve) që kanë qasje në sajtin e intranetit; organi që menaxhon sajtin e intranetit dhe ngarkon/përditëson informacionin përkatës; dhe llojin e informacionit në dispozicion.

Çdo koment tjetër në lidhje me pyetjet 62-1 deri në 62-9 mund të shtohet këtu.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Nuk ka asnjë sajt intraneti brenda sistemit gjyqësor. Megjithatë, ekziston një sajt interneti, ku shfaqen informacionet përkatëse (rregulloret e reja dhe udhëzimet administrative) dhe lajmet. Kjo është për KG-JK-në dhe të gjitha gjykatat. Shih <https://www.gjyqesori-rks.org/?lang=en>

Rekomandimi 12: *Krijimi i një saji intraneti për gjykatat mund të hulumtohet për të mundësuar shkëmbimin e informacionit të brendshëm dhe më konfidencial, të rëndësishëm për punën e gjykatave.*

Megjithëse konsiderohet si 'aplikacion kompjuterik jo kritik' në pakon e mjeteve të CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike, krijimi i një intraneti do të ishte një mjet i vlefshëm në shkëmbimin e informacionit të brendshëm dhe më konfidencial, të rëndësishëm për punën e gjykatave. Sisteme të tilla janë vendosur në disa vende në Evropë.

3.6. Përdorimi i TI për përmirësimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor

Grupi i pyetjeve në këtë seksion synon të vlerësojë përdorimin e mjeteve të TI-së në kontekstin e administrimit të gjykatave dhe menaxhimit të lëndëve gjyqësore, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të sistemit gjyqësor.

3.6.1. Sistem për menaxhim të lëndëve

63-1 A ekziston sistemi për menaxhimin e lëndëve (SML) ? (Softuer i përdorur për regjistrimin e procedurave gjyqësore dhe për menaxhimin e tyre)

Po ☐ Jo ☐

63.1.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

	Norma e disponueshmërisë së SML-së	Statusi i lëndës në internet	Databazë e centralizuar ose e ndër-operueshme	Sinjale të hershme paralajmërimi (për menaxhimin e lëndëve aktive)	Statusi i integritetit/lidhjes së një SML-je me ndonjë mjet statistikor
Civile dhe/ose ekonomike	○100% ○50-99% ○10-49% ○1-9% ○0% (NAP) ○NA	☐ I qasshëm për palët ☐ publikimi i vendimit në internet ☐ të dyjat ☐ aspak i qasshëm	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Plotësisht i integruar përfshirë IB i integruar jo i integruar por i lidhur aspak i lidhur

Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ I qasshëm për palët ☐ publikimi i vendimit në internet ☐ të dyjat ☐ aspak i qasshëm	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ Plotësisht i integruar përfshirë IB ☐ i integruar ☐ jo i integruar por i lidhur ☐ aspak i lidhur
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ I qasshëm për palët ☐ publikimi i vendimit në internet ☐ të dyjat ☐ aspak i qasshëm	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ Plotësisht i integruar përfshirë IB ☐ i integruar ☐ jo i integruar por i lidhur ☐ aspak i lidhur

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 63-1 synon të vlerësojë disponueshmërinë (shkalla e disponueshmërisë), qasshmërisë nga palët në lëndë dhe veçoritë e lidhjes së Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve (SML) në gjykata, d.m.th. softueri ose aplikacionet e përdorura për regjistrimin dhe menaxhimin e procedurave gjyqësore.

Shkalla e disponueshmërisë së SML-së % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse sistemi vendoset në të gjitha gjykatat;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse sistemi është vendosur në shumicën e gjykatave (në të gjitha përveç disa gjykatave të specializuara për shembull);
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse sistemi vendoset në disa gjykata (vetëm gjykatat e apelit për shembull);
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse SML sapo ka filluar së vendosuri ose është në fazë testimi;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse SML nuk ekziston fare për çështjen përkatëse (civile, ekonomike, penale, administrative);
- NA duhet të zgjidhet nëse ekziston një SML, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Statusi i lëndës në internet - kjo kolonë kërkon të specifikojë nëse SML tregon statusin e lëndës në internet, p.sh. datat e seancave për palët ose përmbajtjen e lëndës siç janë dokumentet e palëve, vendimet, etj.

I qasshëm për palët do të thotë që palët në rast mund të qasen përmes internetit dhe të shohin statusin e lëndës së tyre, seancat e caktuara, dokumentet etj.

Publikimi i vendimit i referohet qasshmërisë në internet të vendimit direkt nga SML.

Të dyja duhet të zgjidhet kur ekziston opsioni i parë dhe i dytë.

Fare i qasshëm - ky opsion duhet të zgjidhet kur palët nuk mund ta ndjekin fare statusin e lëndëve të tyre në internet. Megjithatë, kjo nuk përjashton mundësinë që gjyqtarët dhe stafi i gjykatës të kenë qasje dhe të punojnë në lëndën në SML.

Databazë e centralizuar ose e ndër-operueshme i referohet ekzistencës së një databaze për ruajtjen e lëndëve të konsoliduar në nivel kombëtar (ose të databazës së ndër-operueshme) për të gjitha gjykatat. Nëse nuk ka centralizim të të dhënave (për shembull, nëse të dhënat ruhen në një server gjykatë pa asnjë mundësi konsolidimi), përgjigja duhet të jetë “Jo”.

Sinjale të paralajmërimit të hershëm i referohet aftësisë së softuerit për të gjeneruar sinjale paralajmëruese në mënyrë që të ketë një menaxhim dinamik dhe proaktiv të lëndëve. Sinjalet e paralajmërimit të hershëm mund t'i referohen njoftimeve të kohës së kaluar për të parandaluar tejkalimin e pragjeve të paracaktuara (zbulimi për shembull i lëndëve të pazgjidhura më të vjetra se dy vjet), ose raporteve të automatizuara, që përmbajnë të dhëna për rastet kritike (p.sh., paralajmërimet për lëndët më të vjetra ose lëndët pa aktivitet/lëndët boshe). Kutia e komenteve mund të tregojë nëse vendosja e sinjaleve të paralajmërimit të hershëm bazohet tërësisht ose pjesërisht në udhëzimet e Qendrës CEPEJ-SATURN.

Statusi i integritetit/lidhjes së një mjeti statistikor me SML: ndërsa SML është burimi kryesor i të dhënave statistikore për vlerësimin dhe analizën e punës së gjykatave, mjetet statistikore mund të integrohen në SML për të mundësuar zhvillimin automatik të raporteve statistikore. Kjo kolonë i referohet integritetit të modulit statistikor brenda SML-së dhe nivelit të tij të zhvillimit.

Inteligjenca e Biznesit (IB) i referohet mjeteve dhe metodave që mundësojnë mbledhjen, konsolidimin, modelimin dhe paraqitjen e të dhënave. Ajo synon t'i ofrojë menaxherit të organizatës (p.sh. Kryetarit të gjykatës, Këshillit të gjykatës, Këshilltarit) një përmbledhje të veprimtarisë së përpunuar për ta ndihmuar atë të marrë vendime. Në këtë drejtim, kategoritë e parashikuara përfshijnë:

- Plotësisht i integruar përfshirë IB - ky opsion duhet të zgjidhet nëse moduli statistikor është integruar plotësisht në SML me modelim dhe raportim të sofistikuar duke përfshirë një modul të IB-së;
- Integruar - ky opsion duhet të zgjidhet nëse mjeti statistikor përfshihet si modul i SML-së me raportim të paracaktuar dhe mundësi raportimi ad hoc, por pa IB;
- Jo i integruar por i lidhur - ky opsion duhet të zgjidhet nëse ekziston një modul i veçantë statistikor, por i lidhur me SML ose raportimi statistikor është i mundur përmes importimit të të dhënave nga SML;
- Nuk lidhet fare - ky opsion duhet të zgjidhet nëse nuk ka lidhje midis SML-së dhe mjetit ose modulit statistikor.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Sistem për menaxhim të lëndëve

Projekti SMIL, siç shpjegohet më lartë, filloi në vitin 2014 dhe po financohet nga Norvegjia. Që nga janari 2018 ai u zbatua gradualisht në disa gjykata dhe për disa lloje të lëndëve. Në vitin 2020 SMIL u vendos dhe u zbatua në të gjitha gjykatat themelore, për të gjitha llojet e lëndëve. Vendosja dhe zbatimi i SMIL-it në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme është në proces.

Përdorimi i SMIL-it është i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët, stafin që i ndihmon gjyqtarët drejtpërdrejt dhe personelin administrativ. Lëndët përpunohen dhe menaxhohen përmes SMIL-it nga regjistrimi deri në ekzekutim. Ky është një sistem i bazuar në detyra, që do të thotë se detyrat dërgohen dhe merren automatikisht midis personelit administrativ (kur rastet paraqiten në gjykatë, për shembull), personelit që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët (për të caktuar seanca, etj.) dhe gjyqtarëve (për vendime dhe aktgjykime). Jo të gjitha detyrat mund të kompletohen aktualisht brenda SMIL-it për arsye të ndryshme. Për shembull, duke pasur parasysh se nuk ka komunikim elektronik midis gjykatave dhe avokatëve (siç shpjegohet më poshtë në pikën 3.6.4), thirrjet e gjykatave vazhdojnë të përgatiten me dorë, dhe jo me SMIL. Thirrjet me letër më pas dorëzohen nga zyrtarët e dorëzimit ose me postë te avokatët.

Që nga shkurti 2020, lëndët në gjykata themelore caktohen automatikisht përmes SMIL-it, me disa përjashtime: lëndët paraprake për shembull, dhe anëtarët e panelit (në rastet me një panel prej tre gjyqtarësh) akoma caktohen me dorë. Gjithashtu, kur gjyqtarët ngrihen në pozitë ose transferohen në një departament ose gjykatë tjetër, lëndët nuk mund të ricaktohen automatikisht.

Statusi i lëndës në internet

Në vitin 2020 u zhvillua një funksionalitet i ri në uebsajtin e gjykatave për të kontrolluar statusin e lëndëve në internet.

Basic Court Pristina

Case Status Lookup

Hearing Schedule

All schedules

Basic Court Pristina
Court branch of Glogovac
Court branch of Gracanica
Court branch Lipjan
Court branch Podujevo

Time	Case	Room No	Judge	Status
09:00	2019:087702		Elife Uka	
09:00	2019:274401	Zyra e gjykatësit	Fisnik Nuli	
09:00	2019:199487	Zyra e gjykatësit	Dren Rrogova	

GJKATA IME

"My GJKATA IME is a window into courts, reflecting and summarizing important information on court functioning, party rights and obligations in court proceedings, as well as other useful information that enables citizens to be informed and access online services provided by courts and the Kosovo Judicial Council."

gjkataime.org

Case Status

On this page you may search for the status of your case in court and the history of actions from the recording of your case. Searching is performed through the case number and reflects the data in the case management information system (CMIS). Currently, it shows the results for Basic Courts and Kosovo Court of Appeals, while the system is constantly updated and improved.

How to search the case status: ▼

e.g. 2019:123456 Case Status Lookup

View the video tutorial

*in case you have filed a case with the court and the search for its status shows no results on this page, this does not necessarily mean that the case in question is not in the court. The case may not have been recorded yet in the electronic system (CMIS) or the database needs to be updated. The case status data on the court webpage are updated every 24 hours.

Palët, përfshirë avokatët, mund të kontrollojnë statusin e një lënde duke shënuar numrin e lëndës dhe të shohin nëse lënda i është caktuar një gjyqtari, nëse seancat janë zhvilluar ose do të zhvillohen, nëse lënda ka përfunduar, etj.

Avokatët e intervistuar përmendën disa dobësi në këtë funksionalitet të ri. Para së gjithash, për të kontrolluar statusin e një lënde, është e nevojshme të keni numrin lëndës në SMIL. Para zhvillimit dhe zbatimit të SMIL-it, u përdor një sistem i ndryshëm i numërimit të lëndëve. Aktualisht, lëndët prandaj kanë një numër “të vjetër” (si Cnr 1765/2015) si dhe një numër “të ri”, i cili iu caktua lëndës gjatë regjistrimit në SMIL (siç është 2019: 203735). Disa avokatë mund të mos kenë numrin e ri në SMIL për disa nga lëndët e tyre nëse nuk është mbajtur ende seanca. Nëse ata dëshirojnë të shohin statusin e këtyre lëndëve në internet, ata duhet të kërkojnë nga gjykata.

Për më tepër, funksionaliteti i ri i statusit të rastit në internet nuk siguron të gjithë historinë e lëndës, por vetëm të dhënat nga momenti i regjistrimit të lëndës në SMIL. Për shembull, do të tregohet se një rast është ngritur në gjykatë në vitin 2019 sepse kjo është kur rasti është regjistruar në SMIL, por në fakt mund të ndodhë që ky rast të jetë ngritur në gjykatë një vit më parë.

Disa avokatë të intervistuar me qëllim të këtij vlerësimi gjithashtu u përpoqën të kontrollonin statusin e lëndëve të tyre. Për disa nga lëndët, nuk u shfaqën të dhëna, edhe pse lëndët kanë përfunduar dhe vendimi është dhënë. Në punëtorinë e datës 21 tetor 2021, përfaqësuesi i Departamentit të TI-së të KGJK-së sqaroi se në vitin 2020 ka pasur disa probleme teknike me këtë funksionalitet të ri, por që kryesisht janë rregulluar. Megjithatë, për shkak se shpesh ka vonesa të konsiderueshme në procedura, avokatët nuk kanë informacion për periudha të gjata kohore dhe nuk kanë zgjidhje tjetër përveçse të vizitojnë personalisht gjykatat për të përpjekur të njoftohen për zhvillimet e mundshme në rastet e tyre.

Së fundi, vlen të përmendet se funksionaliteti i ri i statusit të lëndës në internet tregon se cilit gjyqtar i është caktuar lënda, edhe para se të zhvillohej një seancë për lëndën.

Sinjale të paralajmërimit të hershëm

Nuk ka alarme në SMIL, përveç disa njoftimeve për të informuar gjyqtarët se kur do të përfundojnë masat e heqjes së lirisë (të tilla si paraburgimi). Gjyqtarët e intervistuar shpjeguan se ata vazhdojnë të mbajnë gjurmët e afateve vetë, me dorë, me ndihmën e zyrtarëve ligjorë që punojnë me ta.

Mjet statistikor

Një mjet statistikor është i integruar në SMIL. Në vitin 2020, kishte rreth 3 raporte statistikore të disponueshme në SMIL. Një raport monitoron rrjedhën e lëndës: numri i lëndëve të pazgjidhura, të ardhura dhe të zgjidhura, për kategoritë kryesore të lëndës. Një raport tjetër statistikor monitoron vjetërsinë e lëndëve të pazgjidhura. Një raport i tretë monitoron sistemin automatik të caktimit të lëndëve. Raportet shitesë statistikore janë duke u zhvilluar si dhe një modul mbi statistikat.

Rekomandimi 13: *Vazhdoni të kontribuoni në burimet njerëzore dhe financiare për përmirësimin e veçorive të SMIL-it, veçanërisht në lidhje me futjen e një mjeti sinjalizues të paralajmërimit të hershëm, i cili do të përmirësonte efikasitetin dhe do të rezultonte në mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut në rastet penale që përfshijnë kufizime të lirisë, dhe zhvillimin e mëtejshëm të një mjeti statistikor për të mundësuar që raportet statistikore të gjenerohen automatikisht.*

Për të përmirësuar veçoritë e SMIL duhet të bëhet rregullisht një rishikim i detajuar i sistemit (për shembull në baza vjetore). Kjo do të mundësojë të identifikohen dhe rregullohen gabimet.

3.6.2. Regjistra të kompjuterizuar të menaxhuar nga gjykatat

63-2 Regjistra të kompjuterizuar të menaxhuar nga gjykatat

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	<i>Të dhëna të konsoliduara në nivel nacional</i>	<i>Shërbime të disponueshme në internet</i>	<i>Modul statistikor i integruar ose i lidhur</i>
Regjistri i tokës	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐
Regjistri i biznesit	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐

Koment – nëse ekziston në regjistra të tjerë, ju lutemi specifikoni

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 63-2 ka të bëjë me disponueshmërinë e regjistrave të kompjuterizuar dhe veçoritë e tyre si niveli i konsolidimit në nivel kombëtar, disponueshmërinë në internet dhe integrimin e një moduli statistikor. Regjistri në këtë pyetje i referohet biznesit, tokës dhe sistemeve të tjera të regjistrimit administrativ, jo sistemit të regjistrimit të lëndëve si i tillë (i përfshirë në SML).

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse të gjitha ngjarjet e regjistrit janë në sistem;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse pothuajse të gjitha ngjarjet e regjistrit janë në sistem me përjashtim të disa lëndëve;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse sistemi është vendosur në disa gjykata (për shembull nëse ka një aplikacion të ri dhe ngarkohen vetëm lëndë të reja ndërsa të dhënat e vjetra ende nuk janë bartur ose nuk janë futur);
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse regjistri i kompjuterizuar sapo ka filluar së vendosuri ose është në fazë testimi;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse regjistri i kompjuterizuar nuk ekziston;
- NA duhet të zgjidhet nëse ekziston një regjistër i kompjuterizuar, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Shërbimi i disponueshëm në internet: shërbimi i regjistrit mund të konsiderohet i disponueshëm në internet nëse profesionistët ose përdoruesit munden, të paktën, të konsultojnë përmbajtjen e tij ose të marrin ekstrakte të përmbajtjes së tij nëpërmjet një shërbimi në internet. Prania e vetme e informacionit përshkrues

mbi funksionimin e regjistrat në fjalë ose mbi termet dhe kushtet e konsultimit nuk e cilëson regjistrin si “të disponueshëm në internet”.

Moduli statistikor i integruar ose i lidhur: kjo kolonë i referohet integritet të një moduli statistikor brenda sistemit. Nëse raportet statistikore mund të gjenerohen drejtpërdrejt nga sistemi ose indirekt duke u lidhur me sistemin, përgjigja duhet të jetë “Po”.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë. Gjithashtu, informacioni për regjistrat e tjerë të kompjuterizuar duhet të raportohet këtu.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Nuk ka asnjë regjister të kompjuterizuar të menaxhuar nga gjykatat.

3.6.3. Sistemet e gjykatave për menaxhim buxhetor dhe financiar

63-6 Sistemet e gjykatave për menaxhim buxhetor dhe financiar

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Të dhëna të konsoliduara në nivel nacional</i>	<i>Sistemi që komunikohet me ministri të tjera (në aspektin financiar ndër të tjera)</i>
<i>Menaxhimi buxhetor dhe financiar i gjykatave</i>	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐
<i>Menaxhimi i shpenzimeve gjyqësore</i>	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐
Tjetër	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐

Koment - nëse tjetër, ju lutemi specifikoni:

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 63-6 fokusohet në mjetet e TI-së të përdorura me qëllim të menaxhimit buxhetor dhe financiar të gjykatave. Ka të bëjë me disponueshmërinë e TI-së për të informuar krerët e gjykatave për buxhetin e alokuar dhe për t'i paralajmëruar ata për shpenzimet e kryera (për shembull, mallrat dhe shërbimet që lidhen me funksionimin e gjykatave, menaxhimin e objekteve, etj.).

Menaxhimi buxhetor dhe financiar i gjykatave lidhet me mjetet e TI-së që informojnë krerët e gjykatave për buxhetin e ndarë, nën-zërat e tij dhe u mundësojnë atyre të monitorojnë përdorimin e burimeve të tilla.

Menaxhimi i shpenzimeve të drejtësisë lidhet me mjetet e TI-së që informojnë krerët e gjykatave për shpenzimet e lidhura vetëm me shpenzimet e drejtësisë (p.sh. kostot e procedurave ligjore dhe shërbimeve të tjera që lidhen me çështjen e paguar nga palët gjatë procedurave, të tilla si tarifat gjyqësore, këshillat juridike, përfaqësimi ligjor, tarifat e transportit, etj.).

Sistemi që komunikon me ministri të tjera (në aspektin financiar ndër të tjera): qëllimi është të identifikohet nëse teknologjitë e informacionit përdoren - në thelb midis gjykatave dhe ministrisë përgjegjëse për financat - në mënyrë që të lehtësohet monitorimi i shpenzimeve.

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse mjeti është vendosur në çdo gjykatë dhe i gjithë informacioni është i disponueshëm në kategori të mjaftueshme për krerët e gjykatave për të monitoruar situatën;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse mjeti është vendosur në të gjitha gjykatat dhe shumica e informacionit është në dispozicion;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse sistemi është vendosur në disa gjykata ose ekziston por informacioni i disponueshëm është i kufizuar;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse mjeti sapo ka filluar së vendosuri ose është në fazë testimi;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse mjeti i tillë nuk ekziston;
- NA duhet të zgjidhet nëse ekziston një mjet i ngjashëm, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Të dhënat e konsoliduara në nivel kombëtar: informacioni për të gjitha gjykatat mund të konsolidohet drejtpërdrejt sepse është brenda një sistemi ose është i përbërë nga sisteme më të pajtueshme që mundësojnë konsolidimin e lehtë të të gjitha kategorive në nivel kombëtar. Nëse kjo nuk ekziston, atëherë përgjigja duhet të jetë "Jo".

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, sidomos në lidhje me kategorinë 'tjetër', nëse është relevante.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Pasi procesi i decentralizimit nga KGJK në gjykata ndodhi në vitin 2015, gjykatat mund të bëjnë shpenzime vetë.²³ Gjykatat kanë buxhetin e tyre vjetor dhe përpunojnë të gjitha pagesat përmes sistemit elektronik të Ministrisë së Financave të quajtur “Sistemi informativ i menaxhimit të financave publike”.²⁴ Për shembull, gjykatat përpunojnë pagesën e avokatëve të caktuar nga gjykata sipas detyrës zyrtare, ekspertëve të gjykatave, gjyqtarëve porotë, shërbimet postare për dërgimin e thirrjeve gjyqësore, faturat, etj. Këto pagesa përpunohen manualisht. Për shembull, avokatët dorëzojnë fatura në recepsionin e gjykatës për seancat në të cilat ata kanë marrë pjesë dhe njësia financiare financon pagesën pasi marrjes së miratimit nga disa persona në gjykatë.

Rekomandimi 14: Zhvilloni një aplikacion për kontabilitet për të mbajtur të dhëna të përditësuara për një përdorim efikas ose burime në nivel gjykatë.

Pakoja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për Drejtësi kibernetike shpjegon se një numër i caktuar i mjeteve të TI-së, duke përfshirë një “aplikacion për kontabilitet”, janë kritike për funksionimin e gjykatave dhe se pa këto mjete, gjykatat nuk mund të funksionojnë ose do të funksiononin me vështirësi të mëdha.²⁵ Informacioni nga sistemet e menaxhimit financiar dhe të dhënat nga SMIL duhet të lexohen së bashku për të marrë një pasqyrë të plotë të mënyrës së përdorimit të burimeve.

3.6.4. Mjetet e matjes për të vlerësuar ngarkesën e punës së gjyqtarëve dhe personelit jo-gjyqtar

63-7 Mjetet e matjes për të vlerësuar ngarkesën e punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe/ose stafit jo-gjyqtar/jo-prokuror (mjet që matë sasinë e aktivitetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe/ose stafit jo-gjyqtar/jo-prokuror - për shembull numrin e lëndëve të zgjidhura)

Po ☐ Jo ☐

63.7.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Të dhëna të përdorura për monitorimin në nivel nacional</i>	<i>Të dhëna të përdorura për monitorimin në nivel lokal të gjykatave</i>	<i>Mjet i integruar në SML</i>
Për gjyqtarë	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐

23 Shih Udhëzimet Administrative Nr. 01/2015 të 20 gushtit 2015 dhe Nr. 01/2019 të 21 qershorit 2019 (në dispozicion vetëm në shqip) lidhur me përgjegjësitë në fushat e buxhetit dhe financave, personelit, prokurimit dhe logjistikës:

• <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/UDHEZIM%20ADMINISTRATIV%20%2001%202015%20NE%20ZBATIM%20TE%20VENDIMIT%20TE%20KGJK%20PER%20DELEGIM%20TE%20PERGJEGJESIVE.pdf>

• [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/47946_Udhezimi_administrativ_\(nr.01-2019\)_per_nderjen_e_pergjegjesive_te_SKGJK_dhe_te_Gjykatave_ne_ceshtjet_personelit_buxhetit_financave_logjistikes_dhe_prokurimit.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/47946_Udhezimi_administrativ_(nr.01-2019)_per_nderjen_e_pergjegjesive_te_SKGJK_dhe_te_Gjykatave_ne_ceshtjet_personelit_buxhetit_financave_logjistikes_dhe_prokurimit.pdf)

24 Në shqip: “Sistemi Informativ i menaxhimit të financave publike të Kosovës (SIMFK)”

25 Shih pakon e mjeteve për mbështetjen e zbatimit të udhëzimeve se si ta thelloni ndryshimin drejt drejtësisë kibernetike, të miratuar në takimin e 32-të plenar të CEPEJ, 13-14 qershor 2019, Lista e Aplikacioneve Kompjuterike Kritike, f.16.

Për prokurorë	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐
Për staf jo-gjyqtar/ jo-prokuror	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 63-7 i referohet përdorimit të mjeteve të TI-së me qëllim të përcaktimit të sasisë së aktivitetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe/ose personelit jo-gjyqtar/jo-prokuror - (për shembull për numrin e lëndëve të pranuar, të zgjidhura, transferuara etj. për gjyqtar). Ky mjet mund të integrohet brenda SML-së ose të lidhet me të - në të dy rastet përgjigja duhet të jetë “Po”. Specifikimi i mëtejshëm i veçorive të mjetit mund të bëhet në pjesën e dytë të pyetjes.

Shkalla e disponueshmërisë së mjetit % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse mjeti është vendosur në çdo gjykatë dhe i tërë informacioni është në dispozicion;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse mjeti është vendosur në të gjitha gjykatat dhe shumica e informacionit është në dispozicion;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse sistemi është vendosur në disa gjykata ose ekziston por informacioni i disponueshëm është i kufizuar;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse mjeti sapo ka filluar së vendosuri ose është në fazë testimi;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse mjeti i tillë nuk ekziston;
- NA duhet të zgjidhet nëse ekziston një mjet i ngjashëm, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Të dhënat e përdorura për monitorim në nivel kombëtar: informacioni për të gjitha gjykatat mund të monitorohet drejtpërdrejt nga një autoritet qendror (p.sh. Këshilli i Lartë Gjyqësor) sepse është brenda një sistemi ose është i përbërë nga sisteme më të pajtueshme dhe komunikuese që mundësojnë monitorimin e ngarkesës së punës në nivel kombëtar.

Të dhënat e përdorura për monitorim në nivel gjykate: informacioni është i disponueshëm dhe monitorohet në nivel gjykate (p.sh., nga Kryetari i Gjykatës).

Mjet i integruar në SML do të thotë se mjeti për matjen e ngarkesës së punës është pjesë e SML-së. Përgjigja duhet të jetë “Jo” nëse të dhënat janë në dispozicion nga mjete/burime të tjera, por nuk mund të nxirren nga SML-ja.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Siç u shpjegua më lart, SMIL-i gjeneron një raport statistikor që jep të dhëna për numrin e lëndëve të pazgjidhura, të ardhura dhe të zgjidhura për kategoritë kryesore të lëndëve, për gjykatë dhe gjyqtar. Është parashikuar gjithashtu që SMIL-i të integrojë në të ardhmen një mjet matës për të vlerësuar ngarkesën e lëndëve të gjykatave dhe gjyqtarëve: disa panele për gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave janë hartuar dhe zhvillimi i tyre në SMIL është gati të finalizohet. Mjeti megjithatë do të duhet të mbështetet në numrin faktik të gjyqtarëve dhe stafit, të shprehur në EOP.

Rekomandimi 15: Zhvilloni mjete matëse për të vlerësuar ngarkesën e lëndëve të gjykatave, prokurorive dhe punonjësve të tyre, duke u mbështetur në numrin faktik të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit, të shprehur në EOP.

Shih edhe Rekomandimin 3.

3.7. TI e përdorur për komunikime ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe përdoruesve të gjykatave

Grupi i pyetjeve në këtë seksion trajton çështjen e disponueshmërisë së mjeteve të TI-së si mjet për të lehtësuar komunikimin midis gjykatave, si dhe me profesionistët dhe përdoruesit e gjykatave. Pyetjet synojnë të vlerësojnë llojin dhe fushëveprimin e veprimeve që mund të kryhen në mënyrë elektronike, të tilla si mundësia për të paraqitur një rastin, për të kërkuar këshilla juridike, për të transmetuar thirrje, komunikime midis gjyqtarëve dhe avokatëve, shkëmbim dokumentesh në mënyrë elektronike, video-konferenca, incizim i seancave ose debateve, paraqitje dhe pranueshmëri të provave elektronike.

3.7.1. Paraqitja e një lënde në gjykatë përmes mjeteve elektronike

64-2 A ka mundësi të paraqitjes së një lënde në gjykata përmes mjeteve elektronike?(mundësi për paraqitjen e një lënde përmes mjeteve elektronike, për shembull email ose formular në uebsajt)

Po ☐ Jo ☐

64.2.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	<i>Paraqitja njëkohësisht e lëndëve në formë letre mbetet i detyrueshëm</i>	<i>Kornizë legjislative specifike që autorizon paraqitjen e një lënde</i>	<i>Mjet i integruar/i lidhur me SML</i>
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐

Administrative	○100%			
	○50-99%			
	○10-49%			
	○1-9%	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐
	○0% (NAP)			
	○NA			

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-2 synon të vlerësojë shkallën në të cilën është e mundur të paraqitet një lëndë në gjykatë përmes mjeteve elektronike (p.sh., përmes një emailit ose duke plotësuar një formular në uebsajt).

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse paraqitja elektronike është e mundur në të gjitha gjykatat;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse paraqitja elektronike është e mundur në shumicën e gjykatave;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse paraqitja elektronike është e mundur në disa gjykata;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse paraqitja elektronike është e mundur vetëm në gjykata pilot;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse paraqitja elektronike nuk ekziston për atë çështje specifike;
- NA duhet të zgjidhet nëse paraqitja elektronike është e mundur, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Korniza legislative specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë për t'u rikthyer në mjetet e komunikimit elektronik gjatë paraqitjes së një lënde në gjykatë, përveç ose si zëvendësim i procedurave në letër.

Mjet i integruar/i lidhur me SML - kjo kolonë mund të përgjigjet me “Po”, nëse të dhënat ose meta të dhënat (metadata) nga lënda e paraqitur në mënyrë elektronike mund të importohen drejtpërdrejt në SML (edhe nëse në fakt verifikohen me dorë para importimit).

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, sido-mos nëse ekziston paraqitja elektronike në lidhje me çështje të tjera ose kategori të tjera lëndësh.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Lëndët civile dhe/ose ekonomike, dhe lëndët administrative

Nuk është e mundur që palët (përfshirë avokatët) të paraqesin lëndë përmes mjeteve elektronike. U lejua përjashtimisht në mars-prill 2020 kur gjykatat u mbyllën për shkak të pandemisë, siç shpjegohet më poshtë (4.1. Aktiviteti i gjykatës gjatë pandemisë).

Lëndë penale

Sistemi SMIL zhvilloi ndërveprimin (transferimin e lëndëve në mënyrë elektronike) nga policia në prokurori dhe nga prokuroria në gjykata. Prandaj, lëndët penale mund të paraqiten nga prokuroria në gjykata përmes mjeteve elektronike, përmes SMIL-it. Avokatët nuk kanë qasje në SMIL.

Rekomandimi 16: *Duhet të shfrytëzohet mundësia që palët/avokatët të paraqesin lëndë dhe dokumente procedurale përmes mjeteve elektronike, të cilat kanë ndodhur gjatë pandemisë (shih më lart 3.1 “Përdorimi i TI-së në gjykata gjatë pandemisë”).*

Sipas Udhëzimeve të CEPEJ 2016 për drejtësi kibernetike, në shumicën e vendeve, avokatët tani janë në gjendje ose së shpejti do të jenë në gjendje të komunikojnë, plotësisht elektronikisht me gjykatat për transmetimin e dokumenteve të tyre procedurale, parashtrësive ose dokumenteve të tjera të shkresës së lëndës. Migrimi në një sistem plotësisht elektronik në përgjithësi përfshin dy faza: vendosjen e një komunikimi të sigurt përmes kutive postare elektronike normale dhe futjen e drejtpërdrejtë të dokumenteve të avokatëve në sistemin e informacionit të gjykatës (“e-filing”). Rezultati i pritshëm i këtij procesi është të zvogëlojë ndjeshëm punën e regjistrave të gjykatave, të cilëve do t’u duhet vetëm të verifikojnë paraqitjen dhe efektet e tyre juridike (hapja e shkresës së lëndës, ndërprerja e një afati të parashkrimit, etj.). Vendet që përdorin këtë mjet po shqyrtojnë rifokusimin e punës së regjistrave të gjykatave në aktivitete juridike me vlerë të lartë dhe ndihmë për gjyqtarët dhe prokurorët.

3.7.2. Parashtrimi i kërkesës për ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike

64-3 A është e mundur të kërkohej ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike?

Po ☐ Jo ☐

64.3.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	Zyrtarizimi i kërkesës në formë letrë mbetet i detyrueshëm	Kornizë legjislative specifike lidhur me kërkesat për ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike	Dhënia e ndihmës juridike është edhe elektronike	Informata të disponueshme në SML
Parashtrim i kërkesës në formë elektronike për ndihmë juridike	○ 100% ○ 50-99% ○ 10-49% ○ 1-9% ○ 0% (NAP) ○ NA	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-3 synon të vlerësojë shkallën në të cilën është e mundur të kërkohe ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike (p.sh., përmes një emailit ose duke plotësuar një formular në uebsajt).

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse kërkesat elektronike janë të mundshme për të gjitha llojet e ndihmës juridike;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse kërkesat elektronike janë të mundshme për shumicën e lëndëve;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse kërkesat elektronike janë të mundshme vetëm për disa lloje lëndësh;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse kërkesat elektronike janë në fazën e testimit;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse nuk ekziston mundësia për kërkesa elektronike;
- NA duhet të zgjidhet nëse parashtrimi i kërkesave elektronike është i mundur, por informacioni specifik në lidhje me to nuk është i disponueshëm.

Korniza legislative specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë për t'u rikthyer në mjetet e komunikimit elektronik për të kërkuar dhënien e ndihmës juridike, përveç ose si zëvendësim i procedurave në letër.

Dhënia e ndihmës juridike është gjithashtu elektronike mund të përgjigjet me "Po" nëse vendimi mund të nxirret në sistemin e TI-së (nuk kërkohe që vendimi të jetë automatik).

Informacioni i disponueshëm në SML: pyetja duhet të përgjigjet me "Po" nëse informacioni që pala merr ndihmë juridike është i disponueshëm në SML (p.sh. gjyqtarit që zgjidh lëndën).

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Në vitin 2020, gjatë mbylljes në mars-prill, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas krijoi një sistem të ri, me mbështetje nga GIZ, për t'u mundësuar njerëzve që të aplikojnë në internet për ndihmë juridike, në uebsajt-in e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Shih: <https://anjf.rks-gov.net/>:




Zyrat e ANJF- së


> Prishtine
> Prizren
> Peje
> Mitrovicë
> Gjilan
> Ferizaj
> Gjakovë
> Fushë Kosovë, Drenas
> Istog, Deçan
> Drgash, Suharekë
> Mitrovicë Veriore
> Skenderaj
> Malishevë
> Gracanice
> Kamenicë




Këshilli për Ndihmë Juridike Falas mbajti takimin e rregullt mujor



Agjencia për Ndihmë Juridike Falas mbajti takimin e përbashkët me partnerët e saj





>> Legjislacioni
>> Na ndiqni

Sidoqoftë, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Agjencisë shpjegoi se shumë pak kërkesa u bënë duke përdorur këtë sistem të ri gjatë mbylljes. Aktualisht Agjencia ende merr shumë pak kërkesa online. Në vitin 2020, Agjencia pranoi dhe përpunoi mbi 6000 kërkesa për ndihmë juridike, por një numër shumë i vogël i këtyre kërkesave u paraqitën në internet. Ajo mendon se ky shërbim i ri online nuk është ende i njohur mirë për njerëzit, por gjithashtu dyshon se njerëzit që kërkojnë ndihmë juridike zakonisht përballen me kushte të këqija të jetesës dhe mund të mos jenë të njohur me mjetet elektronike ose mund të mos kenë qasje në TI. Personi që aplikon në internet duhet të plotësojë një formular dhe gjithashtu të bashkëngjisë disa dokumente të skanuara, të cilat mund të komplikojnë procesin e aplikimit.

Rekomandimi 17: *Përdorimi i sistemit online të aplikimeve për ndihmë juridike falas duhet të promovohet dhe lehtësohet, përfshirë përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe mjeteve për ndihmë përdoruesve.*

3.7.3. Transmetimi i thirrjeve për seancë përmes mjeteve elektronike

64-4 A është e mundur të dërgohen thirrjet për takim gjyqësor ose seancë dëgjimore përmes mjeteve elektronike? (takimi gjyqësor ka të bëjë me faza para një seance dëgjimore gjyqësore, me qëllim të ndërmjetësimit ose pajtimit)

Po ☐ Jo ☐

64.4.1 Nëse po, specifíkoni informacionet në vijim:

	Thirrje të krijuara përmes SML-it	Thirrja njëkohësisht në formë letre mbetet e detyrueshme	Pëlqim i përdoruesit për t'u njoftuar përmes mjeteve elektronike	Modalitete (nëse tjetër, ju lutemi specifíkoni në komente)	Kornizë legjislativë specifike
Civile dhe/ose ekonomike	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ SMS ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Penale	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ SMS ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Administrative	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ SMS ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Koment

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-4 eksploron shkallën në të cilën është e mundur të transmetohen thirrjet në një takim gjyqësor (para seancës gjyqësore, me qëllim ndërmjetësimin ose pajtimin) ose një seancë përmes mjeteve elektronike (p.sh., përmes emaili ose duke plotësuar një formular në uebsajt).

“Pëlqimi i përdoruesit për t'u njoftuar përmes mjeteve elektronike” mundëson specifíkimin nëse thirrjet elektronike shkaktohen vetëm me një marrëveshje të shprehur qartë të përdoruesit. Përdoruesi është duke pranuar këtë mënyrë njoftimi e cila është plotësisht e zbatueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës. Përgjigja “Jo” duhet të zgjidhet nëse pëlqimi i përdoruesit është opsional ose nuk kërkohet.

Kolona **“Modalitetet”** plotësohet në mënyrë që të specifíkojë teknologjitë e komunikimit të përdorura. Opsioni **“Aplikacione kompjuterike specifike”** për shembull mund të lidhet me uebsajte të dedikuara për të cilat përdoruesit e gjykatës kanë qasje me identifikues të komunikuar paraprakisht dhe mbi të cilat opinionet ose thirrjet mund të ngarkohen në mënyrë të sigurt.

Korniza legislative specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë për t'u rikthyer në mjetet e komunikimit elektronik gjatë marrjes së thirrjes, përveç ose si zëvendësim i procedurave në letër.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, duke përfshirë kur ekziston paraqitja elektronike në lidhje me çështje të tjera ose kategori të tjera lëndësh, ose përmes modaliteteve dhe jo opsionet e ofruara në tabelë.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Thirrjet gjyqësore mund të gjenerohen automatikisht nga SMIL, por ky funksionalitet nuk po përdoret sepse nuk është e mundur të dërgohen këto thirrje përmes mjeteve elektronike.

Në fund të vitit 2020, KGJK-ja dhe Oda e Avokatëve filluan së diskutuari duke përdorur thirrjet elektronike, me një projekt pilot të zbatuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Ky ishte gjithashtu një nga rekomandimet e Komisionit për Administratën e Gjykatave brenda KGJK-së me qëllim të kufizimit të numrit të seancave të shtyra. Është miratuar nga KGJK-ja në shtator 2020 (KGJK.nr.226/2020). Për më tepër, Plani i Veprimit i bashkangjitur në Strategjinë për Sundimin e Ligjit të miratuar në gusht 2021 parashikon si një nga qëllimet e tij në fushën e E-drejtësisë të fillojë përdorimin e thirrjeve elektronike të gjykatave.²⁶

Rekomandimi 18: *Mundësia e paraqitjes së thirrjeve përmes mjeteve elektronike, duhet të testohet dhe zbatohet më gjerësisht me rishikimet e nevojshme që dalin gjatë fazës së pilotimit. Nevoja për të dorëzuar njëkohësisht thirrjen në letër duhet të hetohet dhe legjislacioni përkatës të rishikohet nëse është e nevojshme.*

3.7.4. Komunikimi elektronik midis gjykatave dhe avokatëve dhe/ose palëve

64-6 A ka mundësi të komunikimit elektronik midis gjykatave dhe avokatëve dhe/ose palëve? (dërgimi i dokumenteve elektronike dhe të dhënave në lidhje me një procedurë gjyqësore me ose pa dokumente të skanuara, kryesisht për të zhvilluar komunikimin e dematerializuar)

Komunikim ndërmjet gjykatës dhe avokatëve që përfaqësojnë palë Po ☐ Jo ☐
 Komunikim ndërmjet gjykatës dhe palëve që nuk përfaqësohen nga avokatë Po ☐ Jo ☐

64.6.1 Nëse po për ndonjërin më sipër, ju lutemi specifikoni informacionin në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Faza të gjykimeve në fjalë</i>	<i>Modalitete (nëse ka dallime sipas fazave të gjykimit ose nëse tjetër, ju lutemi specifikoni në një koment)</i>	<i>Kornizë ligjore specifike</i>
--	--	-----------------------------------	---	----------------------------------

²⁶ Plani i Veprimit i bashkangjitur në Strategjinë për Sundimin e Ligjit, nën E-drejtësi: "Palët thirren në seancë në mënyrë elektronike".

Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Paraqitja e një lënde në një gjykatë ☐ Faza përgatitore për seancë dëgjimore ☐ Menaxhim i orarit të seancave dëgjimore dhe/ose apeleve ☐ Dërgim i vendimeve të gjykatës	☐ 0 ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Paraqitja e një lënde në një gjykatë ☐ Faza përgatitore për seancë dëgjimore ☐ Menaxhim i orarit të seancave dëgjimore dhe/ose apeleve ☐ Dërgim i vendimeve të gjykatës	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Paraqitja e një lënde në një gjykatë ☐ Faza përgatitore për seancë dëgjimore ☐ Menaxhim i orarit të seancave dëgjimore dhe/ose apeleve ☐ Dërgim i vendimeve të gjykatës	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Koment

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-6 lidhet me transmetimin përmes mjeteve elektronike të të dhënave/fajlave të përfshira në një proces gjyqësor me ose pa dokumente të skanuar, në thelb me qëllim të zhvillimit të komunikimit pa letra. Duke pasur parasysh që komunikimi elektronik me gjykatën mund të kufizohet ekskluzivisht për avokatët, pjesa e parë e pyetjes kërkon të tregojë nëse komunikimi elektronik u jepet vetëm avokatëve që përfaqësojnë palët ose nëse ky opsion ekziston edhe për palët që nuk përfaqësohen nga avokatët.

Kolona “**Shkalla e disponueshmërisë së mjeteve**” lidhet me vlerësimin e numrit të gjykatave ku mjeti është në dispozicion, dhe numrin e fazave të gjykimit të përfshira. Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është i mundur për të gjitha llojet e fazave të gjykimit në këtë çështje dhe në të gjitha gjykatat;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është i mundur për shumicën e fazave të gjykimit në këtë çështje dhe në të gjitha gjykatat, ose për të gjitha fazat e gjykimit në shumicën e gjykatave;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është i mundur për disa faza të gjykimit në këtë çështje dhe në disa gjykata;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është në fazën e testimit;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse nuk ekziston mundësia për transmetimin elektronik të dokumenteve;
- NA duhet të zgjidhet nëse është i mundur transmetimi elektronik i dokumenteve, por informacioni specifik në lidhje me këtë mundësi nuk është i disponueshëm.

Kolona “**Modalitetet**” duhet të plotësohet përveç kolonës “**Faza e gjykimeve në fjalë**” në mënyrë që të specifikohen mjetet e komunikimit që përdoren në mënyrë specifike. Nëse zbatohen modalitete të ndryshme të komunikimit në fazat e ndryshme të gjykimeve (email vetëm për fazën përgatitore dhe/ose aplikacion kompjuterik të dedikuar vetëm për transmetimin e vendimeve), duhet të zgjidhen opsione të shumta, duke specifikuar detajet në koment. Ju lutemi vini re se emailat pa nënshkrim elektronik nuk llogariten komunikim elektronik për qëllimin e kësaj pyetjeje.

Korniza ligjore specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë për t’u rikthyer në mjetet e komunikimit elektronik për ndarjen e fajlave dhe të dhënave elektronike, përveç ose si zëvendësim i procedurave në letër. Përgjigja duhet të jetë “Po” kur një tekst legjislativ rregullon të paktën një nga fazat e gjykimit. “Jo” duhet të zgjidhet kur nuk ekziston një bazë e tillë ligjore, edhe pse në praktikë mund të bëhen shkëmbime elektronike midis gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve të gjykatave, për shembull, bazuar në interpretime të gjera të teksteve ligjore.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, sidomos në lidhje me modalitetet e transmetimit elektronik dhe kornizës ligjore.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Në vitin 2020 komunikimi elektronik midis gjykatave dhe avokatëve dhe/ose palëve nuk ishte i mundur. Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në letër.

Dy çështje specifike u ngritën në kontekstin e këtij vlerësimi në lidhje me komunikimin e vështirë midis gjykatave dhe avokatëve.

Dorëzimi i vendimit/aktgjykimit

Vendimet dhe/ose aktgjykimet u dorëzohen avokatëve në letër nga gjykata së bashku me një dëftesë. Periudha kohore për të apeluar vendimin/aktgjykimin fillon të ecë nga momenti që avokatët kanë nënshkruar dëftesën, e cila më pas i kthehet gjykatës. Në praktikë ka sfida dhe vonesa të rëndësishme në procesin e dorëzimit.

Pagesa e tarifave gjyqësore

Një çështje specifike e ngritur në kontekstin e këtij vlerësimi ishte pamundësia që avokatët të paguajnë tarifën gjyqësore në internet. Avokatët duhet të shkojnë në gjykatë; nëpunësi më pas do të përcaktojnë shumën e tarifës gjyqësore bazuar në vlerën e kërkesës. Avokatët marrin një faturë nga nëpunësi dhe më pas duhet ta paguajnë tarifën në bankë. Avokatët pastaj duhet të kthehen në gjykatë me një dëshmi se tarifa gjyqësore është paguar. Gjyqtari nuk e shqyrton kërkesën nëse nuk ka prova që tarifa gjyqësore është paguar. Kjo kërkon shumë kohë sepse avokatët duhet të shkojnë në gjykatë disa herë personalisht.

Rekomandimi 19: *Komunikimet elektronike midis gjykatave, avokatëve dhe palëve të tjera të interesit duhet të promovohen fuqishëm si mjete efikasiteti.*

Shih edhe rekomandimet 12 dhe 15.

Rekomandimi 20: *Një zgjidhje e-Pagesë për tarifën gjyqësore duhet të zhvillohet, së pari të pilotohet në disa gjykata të zgjedhura dhe më vonë të paraqitet në nivel të Kosovës.*

Disa institucione, si Agjencia për Pronësi Industriale kanë zhvilluar një zgjidhje të tillë të e-Pagesave. Është e mundur të gjenerohet një fletë pagese digjitale në internet, e cila më pas mund të printohet.²⁷

3.7.5. Komunikimi elektronik i përdorur nga profesionistë të tjerë përveç avokatëve

64-7 Termat dhe kushtet e komunikimit elektronik të përdorur nga profesionistë të tjerë jo avokatëve (dërgimi i të dhënave elektronike në lidhje me një procedurë gjyqësore me ose pa dokumente të skanuara, kryesisht për zhvillimin e komunikimit të dematerializuar)

	Norma e disponueshmërisë së mjeteve	Modalitete (nëse ka dallime sipas veprave ose nëse tjetër, ju lutemi specifikoni në një koment)	Kornizë ligjore specifike
Agjentë të ekzekutimit (siç përkufizohet in P169 dhe në vijim)	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Noterë (siç përkufizohet in P192 dhe në vijim)	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

²⁷ Agjencia për Pronësi Industriale (KIPA): <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,1> dhe në lidhje me fletëpagesën digjitale: <https://kipa.rks-gov.net/fp/> (vetëm në shqip).

Ekspertë (siç përkufizohet in P202 dhe në vijim)	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Shërbime të policisë gjyqësore	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Koment:

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-7 lidhet me transmetimin përmes mjeteve elektronike të të dhënave/fajlave të përfshira në një proces gjyqësor me ose pa dokumente të skanuar, në thelb me qëllim të zhvillimit të komunikimit pa letra. Vlen të theksohet ndryshimi me pyetjen e mëparshme (64-6): pyetja 64-7 trajton vetëm komunikimin elektronik midis gjykatave dhe profesionistëve të ndryshëm përveç avokatëve, siç janë agjentët e përmbarimit, noterët, ekspertët gjyqësorë dhe të tjerë.

Kolona **“Shkalla e disponueshmërisë së mjeteve”** kërkon të tregohet vlerësimi për numrin e gjykatave ku mjeti është në dispozicion, dhe numrin e llojeve të ndryshme të dokumenteve që janë komunikuar në formë elektronike. Llojet e ndryshme të veprave/akteve/dokumenteve që komunikohen në mënyrë elektronike mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Thirrjet për gjykatë;
- Dëshmitë;
- Vendimet;
- Mjetet juridike;
- Vepra të tjera.

Ju lutemi vini re se disa nga opsionet e ofruara mund të jenë të zbatueshme për të gjithë profesionistët ligjorë dhe procedurat e tyre gjyqësore (të tilla si “Thirrja në gjykatë”), nga ana tjetër, disa nga opsionet mund t’i referohen vetëm një lloji të profesionistëve ligjorë dhe procedurave përkatëse gjyqësore. Ju lutemi mbani në mend se lista nuk është e plotë.

Ju lutemi vini re edhe se emailat pa nënshkrim elektronik nuk llogariten komunikim elektronik për qëllimin e kësaj pyetjeje.

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është i mundur për të gjitha llojet e veprave në këtë çështje dhe në të gjitha gjykatat;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është i mundur për shumicën e veprave në këtë çështje dhe në të gjitha gjykatat ose për të gjitha veprat në shumicën e gjykatave;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është i mundur për disa vepra në këtë çështje dhe në disa gjykata;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse transmetimi elektronik është në fazën e testimit;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse nuk ekziston mundësia për transmetimin elektronik të dokumenteve;
- NA duhet të zgjidhet nëse është i mundur transmetimi elektronik i dokumenteve, por informacioni specifik në lidhje me këtë mundësi nuk është i disponueshëm.

Korniza ligjore specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë për t'u rikthyer në mjetet e komunikimit elektronik për ndarjen e fajlave dhe të dhënave elektronike, përveç ose si zëvendësim i procedurave në letër. Përgjigja duhet të jetë "Po" kur një tekst legjislativ rregullon të paktën një lloj dokumenti.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, sidomos në lidhje me modalitetet e transmetimit elektronik dhe kornizës ligjore.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Në vitin 2020 komunikimi elektronik midis avokatëve dhe profesionistëve që nuk janë avokatë nuk ishte i mundur.

3.7.6. Sistemet e përpunimit online të proceseve gjyqësore të specializuara

64-9 A ka sisteme përpunimi në internet të kontesteve të specializuara? (konteste me vlerë të ulët, pretendime të padiskutueshme, faza përgatitore për zgjidhje të konflikteve familjare, etj. - ju lutemi, specifikoni në seksionin "komente")

Po ☐ Jo ☐

Koment – Ju lutemi përshkruani sistemin që ekziston.

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-9 synon të identifikojë nëse ka sektorë të veçantë të proceseve gjyqësore që drejtohen plotësisht nga makineria, për shembull, disa procese gjyqësore me vlerë të ulët, pretendime të padiskutueshme, faza përgatitore për zgjidhjen e konflikteve familjare, etj.

Komente duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të sistemeve të përpunimit elektronik, aty ku ato ekzistojnë.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Nuk ka sisteme të përpunimit online të proceseve gjyqësore të specializuara në gjykatat e Kosovës.

3.7.7. Video-konferenca midis gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve

64-10 Videokonferencë midis gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve (kjo ka të bëjë me përdorimin e pajisjeve audio-vizuale në kornizën e procedurave gjyqësore siç janë seancat dëgjimore të palëve, etj.)

Po ☐ Jo ☐

64.10.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim dhe përshkruani në komentet e këtij seksioni rastet e përdorimit real të videokonferencës dhe përfitimet e pritura (për shembull, përdorimi i kësaj pajisje për të ulur numrin e transferimeve të të paraburgosurve në gjykatë):

	Norma e disponueshmërisë	Faza e parashtrimit të padisë	Kornizë legislative specifike
Civile dhe/ose ekonomike	○100% 50-99% ○10-49% 1-9% ○0% (NAP) ○NA	☐ Para seancës dëgjimore ☐ Gjatë seancës dëgjimore ☐ Pas seancës dëgjimore	Po ☐ Jo ☐
Penale	○100% 50-99% ○10-49% 1-9% ○0% (NAP) ○NA	☐ Para seancës dëgjimore ☐ Gjatë seancës dëgjimore ☐ Pas seancës dëgjimore	Po ☐ Jo ☐
Administrative	○100% 50-99% ○10-49% 1-9% ○0% (NAP) ○NA	☐ Para seancës dëgjimore ☐ Gjatë seancës dëgjimore ☐ Pas seancës dëgjimore	Po ☐ Jo ☐

Koment

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-10 ka të bëjë me përdorimin e video-konferencës në kuadër të procedurave gjyqësore midis dy vendndodhjeve në kohë reale. Kjo mund (ose jo) të përfshijë incizim të seancës për përdorim të mëvonshëm.

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse video-konferenca është vendosur në të gjitha gjykatat;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse video-konferenca është vendosur në shumicën e gjykatave;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse video-konferenca është vendosur në disa gjykata;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse video-konferenca është vendosur vetëm në gjykatat pilot;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse video-konferenca nuk ekziston për çështjen përkatëse;
- NA duhet të zgjidhet nëse video-konferenca është vendosur, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Faza e parashtrimit të padisë lidhur me video-konferencë ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve përshkruhen si në vijim:

- Para seancës gjyqësore lidhet me të gjitha fazat paraprake të paraqitjes së një lënde në gjykatë ose në seancë. Në çështjet civile, ajo i referohet në thelb zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; në çështjet penale, i referohet fazës së hetimit (p.sh., për menaxhimin e masave që përfshijnë heqjen e lirisë nga prokurori publik).
- Gjatë seancës gjyqësore i referohet dëgjimeve duke përdorur video-konferencë gjatë gjykimit. Në çështjet penale, mund t'i referohet video-konferencës me të dy, të pandehurit ose dëshmitarët që janë në vende të tjera në kohë reale.
- Pas seancës gjyqësore i referohet fazave pasuese të vendimit përfundimtar (p.sh. një dënim në rastet penale) siç është ekzekutimi i dënimeve.

Korniza ligjore specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë e video-konferencës.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë dhe shembuj për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, sidomos në lidhje me fazat e procedurës dhe kornizës ligjore.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Mjetet e video-konferencës (të tilla si ueb-kamerat, aplikacionet për video-konferencat si Zoom) janë në dispozicion në të gjitha gjykatat themelore. Një projekt i financuar nga USAID dhuroi gjithashtu disa pajisje (kamera dhe mikrofona) gjatë vitit. Për shkak të situatës së pandemisë, disa seanca u mbajtën në internet gjatë vitit 2020.

Në përgjithësi, gjyqtarët e intervistuar shpjeguan se video-konferenca përdoret rrallë në gjykata.

Rekomandimi 21: Përdorimi i video-konferencës në procedurat gjyqësore mund të ketë disa përfitime. Megjithatë, përdorimi i tillë nuk duhet të minojë të drejtën për një gjykim të drejtë, siç është mishëruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Gjatë krizës shëndetësore, gjykatave u është dashur të zhvillojnë përdorimin e video-konferencës në procedurat gjyqësore. Siç theksohet në Udhëzimet për video-konferencat në procedurat gjyqësore të miratuara nga CEPEJ më 16-17 qershor 2021, të gjitha garancitë për gjykim të drejtë sipas KEDNJ-së vlejné për seancat në distancë në të gjitha procedurat gjyqësore. Udhëzimet përmbajnë në shtojcë një listë kontrolli të kërkesave themelore për zbatimin e video-konferencës në praktikën gjyqësore.

3.7.8. Incizimi i seancave

64-11 Incizimi i seancave dëgjimore ose debateve (incizimi zanor ose audio-vizual gjatë fazës së hetimeve dhe/ose gjykimeve)

Po ☐ Jo ☐

64.11.1 Nëse po, specifíkoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Lloji i incizimit</i>	<i>Kornizë legislative specifike</i>
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Zanor ☐ Video ☐ Të dyjat	Po ☐ Jo ☐
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Zanor ☐ Video ☐ Të dyjat	Po ☐ Jo ☐
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Zanor ☐ Video ☐ Të dyjat	Po ☐ Jo ☐

Koment

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64-11 ka të bëjë me incizimin e seancave ose debateve - qoftë vetëm audio, vetëm video, ose audio dhe video - gjatë fazave të ndryshme të hetimit dhe/ose gjykimit.

Shkalla e disponueshmërisë % duhet të përcaktohet bazuar në sa vijon:

- 100% duhet të zgjidhet nëse incizimi është vendosur në të gjitha gjykatat;
- 50-99% duhet të zgjidhet nëse incizimi është vendosur në shumicën e gjykatave;
- 10-49% duhet të zgjidhet nëse incizimi është vendosur në disa gjykata;
- 1-9% duhet të zgjidhet nëse incizimi është vendosur vetëm në gjykatat pilot;
- 0% (NAP) duhet të zgjidhet nëse incizimi nuk është i mundur për çështjen përkatëse;
- NA duhet të zgjidhet nëse video-konferenca është vendosur, por informacioni specifik në lidhje me të nuk është i disponueshëm.

Korniza ligjore specifike i referohet ekzistencës së ligjeve që autorizojnë në një mënyrë specifike mundësinë e incizimit të seancave ose debateve.

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë dhe shembuj për të siguruar kontekstin e përgjigjeve të dhëna në tabelë, veçanërisht në lidhje me kuadrin legjislativ (p.sh. specifikoni nëse incizimi është i detyrueshëm apo opsional sipas ligjit).

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Sipas nenit 315(2) të Kodit të Procedurës Penale, shqyrtimi gjyqësor “incizohet me audio ose video ose incizohet me mjete stenografike, përveç nëse ka bazë të arsyeshme për të mos vepruar kështu”.

Gjykatat kanë pajisjet për audio dhe video incizim të seancave në disa nga sallat e tyre të gjyqit, por jo të gjitha. Sidoqoftë, duket se pajisjet janë mjaft të vjetruara. Prandaj, në disa gjykata, disa seanca incizohen herë pas here, me kërkesë të gjyqtarit, kur një lëndë është e rëndësishme për shembull, por në disa gjykata të tjera, seancat nuk incizohen kurrë.

Kjo çështje është shumë e njohur në sistemin e drejtësisë dhe është raportuar në shumë raporte nga organizatat ndërkombëtare.²⁸

Rekomandimi 22: *KGJK-ja dhe gjykatat duhet të bëjnë përpjekje shtesë (burime financiare dhe njerëzore) për të përmbushur kërkesat e parashikuara në ligj në lidhje me incizimet në lëndët penale.*

3.7.9 Provat elektronike

64-12 A janë të pranueshme provat elektronike?

Çështja	Pranueshmëria e provave elektronike	Korniza legjislative
Civile dhe ekonomike	Po ☐ Jo ☐	○ Vetëm ligj i përgjithshëm ○ Ligj i përgjithshëm dhe i specializuar ○ Vetëm ligj i specializuar
Penale	Po ☐ Jo ☐	○ Vetëm ligj i përgjithshëm ○ Ligj i përgjithshëm dhe i specializuar ○ Vetëm ligj i specializuar
Administrative	Po ☐ Jo ☐	○ Vetëm ligj i përgjithshëm ○ Ligj i përgjithshëm dhe i specializuar ○ Vetëm ligj i specializuar

Koment - Pajisje të tjera të komunikimit elektronik ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve

Informacion përkatës nga Shënimi Shpjegues i CEPEJ:

Pyetja 64.12 synon të vlerësojë nëse sistemet gjyqësore pranojnë dëshmi elektronike (p.sh. dokumente numerike, të nënshkruara në mënyrë elektronike ose jo, fajla teknikë të kompjuterizuar si të dhëna të incizuara në kesh (cache) të navigatorëve të internetit, fotografi dhe video digjitale, incizimet të kamerave të sigurisë etj.) ose një dëshmi, të paraqitur në një formë elektronike (p.sh. dokumente të skanuara, fotografi të letrës së digjitalizuar ose të ngjashme). Pyetja gjithashtu synon të vlerësojë nëse pranueshmëria e provave elektronike është parashikuar në mënyrë specifike në kornizën ligjore.

²⁸ Shih për shembull raportin nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Shqyrtimi i Zbatimit të Kodit të Ri të Procedurës Penale të Kosovës”, i nxjerrë në qershor 2016, f. 33 <https://www.osce.org/files/f/documents/0/8/243976.pdf>

Sipas “**Kornizës legislative**”, opsioni “**Vetëm ligj i përgjithshëm**” duhet të zgjidhet nëse korniza legislative nuk përmban ndonjë dispozitë specifike (për shembull, pranimi i ndonjë dokumenti, çfarëdo qoftë natyra e tij - dhe për këtë arsye provat elektronike janë të pranueshme).

Komente duhet të përfshijë informacion shtesë dhe shembuj për të siguruar kontekst për përgjigjet e dhëna në tabelë, sidomos në lidhje me llojet e dëshmive të pranueshme. Për shembull, zbatimi dhe/ose pranimi i “bllokut zinxhir” (teknologjia e ruajtjes dhe transmetimit të informacionit, transparente, e sigurt dhe që funksionon pa një organ qendror kontrolli) si dëshmi dhe/ose transaksion duhet të përmendet në komente.

KOSOVA: njohuri mbi kontekstin

Ky ligj nuk e specifikon ose ndalon paraqitjen e dëshmive elektronike. Megjithatë, siç u shpjegua më lart, nuk ka komunikim elektronik midis gjykatave dhe avokatëve, kështu që provat nuk mund të dorëzohen në mënyrë elektronike.

Shih **Rekomandimin 20**

PJESA 4 - PËRMBLEDHJE E FUSHAVE PËR VEPRIME TË MËTEJSHME DHE REKOMANDIME

Raporti identifikon pesë fusha për veprime të mëtejshme.

I. Vizioni afatgjatë për disponueshmëin dhe përdorimin e mjeteve të TI-së

Rekomandimi 1: Vlerësimi rregullisht i disponueshmërisë së TI-së në gjykata në Kosovë, bazuar në metodologjinë e CEPEJ, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të tyre.

Plotësimi i pyetësorit dhe llogaritja e indeksit të përgjithshëm të disponueshmërisë së TI-së janë të lidhura ngushtë dhe do të ndihmojnë në monitorimin e progresit me kalimin e kohës në lidhje me disponueshmërinë e TI-së në gjykata. Gjatë plotësimit të pyetësorit, duhet të regjistrohen informacionet e mëposhtme për raportet e ardhshme: zyrtari pranë institucionit përkatës që ka dhënë përgjigjen për një pyetje specifike (të dhënat e kontaktit të tij/saj) dhe të gjitha komentet përkatëse. Kjo do të ndihmojë në raportet e ardhshme për të siguruar konsistencën e përgjigjeve (dhe për të shmangur një interpretim të ndryshëm të pyetjes) dhe për të identifikuar evolucionet e mundshme.

Rekomandimi 2: *Të mblidhen dhe të raportohen të dhëna të sakta për buxhetet e aprovuara dhe të realizuara, jo vetëm të dhënat buxhetore zyrtare, por edhe financimet e jashtme.*

Në vlerësimet e mëparshme ne kemi konstatuar se sistemi gjyqësor në Kosovë, ashtu si vendet/entitetet e tjera fqinje, përfiton nga burime të jashtme shtesë të cilat nuk bëjnë pjesë në buxhetet zyrtare dhe nuk figurojnë në statistika. Shterimi progresiv i tyre në një periudhë afatmesme/afatgjatë duhet të merret parasysh nga autoritetet e Kosovës për të garantuar qëndrueshmërinë e reformave, veçanërisht ato që synojnë futjen në përdorim të mjeteve të TIK-ut në gjyqësor. Në të vërtetë, gjatë ndarjes së burimeve për projektet e bazuara në TI, duhet të merren parasysh të gjitha kostot direkte dhe indirekte të përfshira në aplikimin e teknologjisë së re dhe praktikave të reja profesionale dhe buxheti duhet të jetë i madhësisë sipas ciklit jetësor të projektit, sepse duke nënvlerësuar shumën e parave të kërkuara ka shkaktuar probleme për shumë projekte të TI-së (Udhëzimet për drejtësi kibernetike, § 98, 99).

Ne rekomandojmë që KGJK-ja, KPK-ja dhe institucionet e tjera relevante të përfshira të mbledhin dhe raportojnë të dhëna të sakta mbi buxhetet e miratuara dhe të realizuara gjatë vitit referues për gjykatat dhe prokuroritë. Saktësia e të dhënave është vendimtare për planifikimin efikas dhe identifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Të dhënat mbi kontributet e jashtme gjithashtu duhet të mblidhen dhe të merren parasysh në mënyrë adekuate në kontekstin e planifikimit të politikave në këtë fushë.

Rekomandimi 3: Zhvillimi i një vizioni të përgjithshëm dhe afatgjatë për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë nëpërmjet TI-së, i formuluar me objektiva të qarta, të matshme dhe të verifikueshme, ku teknologjia ofron një mjet dhe jo një qëllim dhe që shkon përtej logjikës së projekteve të izoluar. Kjo kontribuon në përfitimin e plotë dhe të qëndrueshëm nga vendosja dhe përdorimi i vazhdueshëm i mjeteve të TI-së.

Paketa e mjeteve të CEPEJ-it 2019 për zbatimin e Udhëzimit të Drejtësisë Kibernetike, shpjegon se qëllimet dhe objektivat duhet të përcaktohen sipas nevojave të forta të qytetarëve dhe përdoruesve, dhe jo sipas teknologjisë. Është thelbësore të prezantohen mjetet e TI-së si një kontribut për një shërbim më të mirë për të gjitha llojet e përdoruesve. Së treti, është e rëndësishme të kesh mbështetje në nivelin më të lartë në mënyrë që të sigurohet zbatimi i suksesshëm. Së katërti, duhet të sigurohet pjesëmarrja efektive e grupeve të ndryshme të përdoruesve.

Rekomandimi 4: Zhvillimi, dhe mundësisht lidhja me SMIL, i një aplikacioni për burimet njerëzore dhe përditësimi i të dhënave për të mbledhur shifrat e EOP-së dhe për të siguruar një identifikim në kohë të problemeve dhe zbatimin e zgjidhjeve.

Pakaja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për Drejtësi kibernetike shpjegon se një numër i caktuar i mjeteve të TI-së, duke përfshirë një “aplikacion për burimet njerëzore”, janë kritike për funksionimin e gjykatave dhe se pa këto mjete, gjykatat nuk mund të funksionojnë ose do të funksiononin me vështirësi të mëdha. Mbledhja dhe raportimi i numrave të EOP-së është thelbësor sepse shifrat jo-EOP tregojnë një numër më të madh të burimeve njerëzore sesa ai në dispozicion në praktikë.

Rekomandimi 5: Kosova duhet të vazhdojë të investojë në profilet e reja të burimeve njerëzore që janë bërë thelbësore për drejtësinë online (kryesisht duke rekrutuar personel të ri kur trajnimi ose ritrajnimi nuk është i mjaftueshëm).

Udhëzimet e CEPEJ për drejtësi kibernetike të vitit 2016 shpjegojnë se zhvillimi i mjeteve të TI-së në gjykata, dhe në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, kërkon një riinvestim të rëndësishëm në burimet njerëzore përmes rekrutimit ose planeve të trajnimit për shërbimet e reja të propozuara (31 §), edhe pse kostot për personelin ligjor për gjyqtarë, prokurorë dhe regjistruar, të paktën për momentin, duhet të mbeten të pandryshuara (§ 27).

Rekomandimi 6: Në përputhje me pakon e mjeteve të CEPEJ për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike, ndikimi i projekteve të TI-së duhet të vlerësohet gjatë zbatimit të projektit dhe/ose pas përfundimit të tij. Duhet të kryhet një anketë e kënaqshmërisë së përdoruesve në SMIL e cila duhet të përfshijë gjyqtarë, prokurorë dhe staf në gjykata dhe prokurori.

Pakaja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike propozon një rrjet për vlerësimin e projekteve të TI-së. Një nga hapat që duhet ndërmarrë është kryerja e një vlerësimi të ndikimit të projektit të kryer gjatë zbatimit të projektit ose pas përfundimit të tij, dhe shqyrtimi i rezultateve të tij.

Udhëzimet sugjerojnë më tej përfshirjen e ekspertëve ose studiuesve të pavarur nga një gamë e gjerë disiplinash në një ushtrim të tillë (Udhëzimet, § 120). Nga njëra anë, kjo u mundëson organizatave të kenë qasje në ekspertizën që normalisht nuk është në dispozicion të tyre (sociologjia, menaxhimi, psikologjia sociale, ekonometria, antropologjia, etj.), dhe nga ana tjetër ndihmon në sigurimin e paanësisë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave kundrejt përdoruesve dhe publikut.

II. Siguria e informacionit të gjykatës dhe mbrojtja e të dhënave

Rekomandimi 7: Sigurimi i sigurisë së të dhënave është një shqetësim kryesor në zbatimin e mjeteve të TI-së në gjyqësor. Nevojitet një politikë sigurie në lidhje me të dhënat gjyqësore, e cila duhet të artikulojë qartë parimet që duhet të informojnë ruajtjen, pronësinë, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave gjyqësore, me synim menaxhimin e rreziqeve dhe jo shmangien e tyre.

Pakaja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike sugjeron një qasje pragmatike gjatë trajtimit të çështjeve të sigurisë në kontekstin e sistemeve të informacionit, e cila informohet me fleksibilitet. Një fleksibilitet i tillë qëndron në artikullimin e një politike të qartë që kërkon të menaxhojë rreziqet në vend që t'i shmangë ato, dhe zbatimin e analizave periodike të rrezikut. Analiza të tilla janë të nevojshme për të gjitha aplikacionet kompjuterike (përfshirë mënyrën në të cilën menaxhohen aplikacionet dhe pajisjet kompjuterike) me rreziqe që vlerësohen si nga këndvështrimi i mundësisë së shfaqjes ashtu edhe nga shkalla e dëmtimit në rast të shfaqjes.

Rekomandimi 8: *Duhet të miratohen rregulla të qarta që përcaktojnë të drejtat e qasjes në dokument, si për përdoruesit në sistemin e drejtësisë ashtu edhe për palët e jashtme në përputhje me të drejtat e privatësisë.*

Ligji i Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është i qartë se si të dhënat personale duhet të menaxhohen nga gjykatat. Pakoja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike nxjerr në pah balancën delikate që duhet të arrihet midis nevojës për anonimizim të të dhënave në dokumentet e vëna në dispozicion të publikut (për arsye të mbrojtjes së të dhënave personale) dhe parimit të drejtësisë së hapur. Prandaj, rregullat e qarta duhet të zhvillohen (dhe zbatohen) të cilat përcaktojnë të drejtat e qasjes në dokumente, si për përdoruesit në sistemin e drejtësisë ashtu edhe për palët e jashtme, mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion dhe autoritetin përgjegjës.

III. Mjetet ndihmëse për vendimmarrje dhe shkrim

Rekomandimi 9: *Përmirësimi i funksionalitetit e databazës ekzistuese të vendimeve gjyqësore, në përputhje me nevojat e përdoruesve, për të siguruar sigurinë juridike, parashikueshmërinë dhe cilësinë e aktgjykimeve.*

Teknologji të tilla si databazat elektronike të praktikës gjyqësore kontribuojnë në rezultate më të drejta, më të barabarta dhe më të parashikueshme. Databaza legjislative dhe e praktikës gjyqësore lehtëson kërkimet nëpër organet e ligjit dhe u vënë në dispozicion një sasi më të madhe të dhënash praktikuesve. Këto mjete ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë juridike, si dhe parashikueshmërinë dhe cilësinë e aktgjykimeve të dhëna, pasi i pajisin gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët më mirë për punën e tyre. Aty ku vendimet janë të parashikueshme, qytetarët kanë një ndjenjë më të mirë se rastet trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykatat. Baza ekzistuese e të dhënave të vendimeve gjyqësore në Kosovë mund të përmirësohet duke zgjeruar funksionalitetet e SMIL-it dhe duke krijuar një lidhje ndërmjet SMIL-it dhe bazës së të dhënave.

Rekomandimi 10: *Përmirësimi i funksionalitetit dhe sigurimi i aksesit në KKKK për gjyqtarët dhe/ose prokurorët si një mjet mbështetës vendimesh, siç parashikohet aktualisht nga ekipi i KKKK-së.*

Regjistri i kompjuterizuar i NCCR-së u plotësua në fund të vitit 2020, por puna për ri-rregullimin e databazës dhe pastrimin e të dhënave vazhdon. Në vitin 2020, përmbajtja e bazës së të dhënave të KKKK-së nuk ishte drejtpërdrejt e disponueshme përmes mjeteve të kompjuterizuara për gjyqtarët dhe prokurorët. Megjithatë, zyrat e gjendjes civile në gjykata filluan të përdorin bazën e të dhënave NCCR në vitin 2020 për përgatitjen e certifikatave të dosjeve penale, pasi kjo konsiderohet më e sakta ndër bazat ekzistuese të të dhënave dhe e vetmja që është e centralizuar.

Gjyqtarëve dhe prokurorëve së shpejti do t'u sigurohet akses direkt dhe së shpejti do të fillojë trajnimi i gjyqtarëve. KGJK është ende duke diskutuar këtë çështje. Në sistemin NCCR janë ndërtuar veçori për të parandaluar abuzimet, p.sh., duke regjistruar çdo akses në sistem.

Rekomandimi 11: *Teknologjitë e mbështetjes së vendimeve të tilla si mjetet ndihmëse shkrimi sigurojnë koherencë dhe ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë në dhënien e aktgjykimeve. Shabllonet ekzistuese në SMIL duhet të përmirësohen, për të pasqyruar nevojat e përdoruesve dhe, aty ku është e mundur, të bazohen në përvojën e zhvilluar në praktikë (duke përfshirë mbështetjen në gjykimet në SMIL në raste të ngjashme). KGJK-ja duhet të marrë drejtimin në këtë proces.*

Rekomandimi 12: Krijimi i një sajti intraneti për gjykatat mund të hulumtohet për të mundësuar shkëmbimin e informacionit të brendshëm dhe më konfidencial, të rëndësishëm për punën e gjykatave.

Megjithëse konsiderohet si ‘aplikacion kompjuterik jo kritik’ në pakon e mjeteve të CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për drejtësi kibernetike, krijimi i një intraneti do të ishte një mjet i vlefshëm në shkëmbimin e informacionit të brendshëm dhe më konfidencial, të rëndësishëm për punën e gjykatave. Sisteme të tilla janë vendosur në disa vende në Evropë.

IV. Mjetet për rritjen e efikasitetit

Rekomandimi 13: Vazhdoni të kontribuoni në burimet njerëzore dhe financiare për përmirësimin e veçorive të SMIL-it, veçanërisht në lidhje me futjen e një mjeti sinjalizues të paralajmërimit të hershëm, i cili do të përmirësonte efikasitetin dhe do të rezultonte në mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut në rastet penale që përfshijnë kufizime të lirisë, dhe zhvillimin e mëtejshëm të një mjeti statistikor për të mundësuar që raportet statistikore të gjenerohen automatikisht.

Rekomandimi 14: Zhvilloni një aplikacion për kontabilitet për të mbajtur të dhëna të përditësuara për një përdorim efikas ose burime në nivel gjykatë.

Pakoja e mjeteve e CEPEJ 2019 për zbatimin e Udhëzimeve për Drejtësi kibernetike shpjegon se një numër i caktuar i mjeteve të TI-së, duke përfshirë një “aplikacion për kontabilitet”, janë kritike për funksionimin e gjykatave dhe se pa këto mjete, gjykatat nuk mund të funksionojnë ose do të funksiononin me vështirësi të mëdha. Informacioni nga sistemet e menaxhimit financiar dhe të dhënat nga SMIL duhet të lexohen së bashku për të marrë një pasqyrë të plotë të mënyrës së përdorimit të burimeve.

Rekomandimi 15: Zhvilloni mjete matëse për të vlerësuar ngarkesën e lëndëve të gjykatave, prokurorive dhe punonjësve të tyre, duke u mbështetur në numrin faktik të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit, të shprehur në EOP.

V. Komunikimi ndërmjet gjykatave, profesionistëve, përdoruesve

Rekomandimi 16: Duhet të shfrytëzohet mundësia e paraqitjes së rasteve dhe dokumenteve procedurale përmes mjeteve elektronike, të cilat ndodhën gjatë pandemisë.

Sipas Udhëzimeve të CEPEJ 2016 për drejtësi kibernetike, në shumicën e vendeve, avokatët tani janë në gjendje ose së shpejti do të jenë në gjendje të komunikojnë, plotësisht elektronikisht me gjykatat për transmetimin e dokumenteve të tyre procedurale, parashtrësive ose dokumenteve të tjera të shkresës së lëndës. Migrimi në një sistem plotësisht elektronik në përgjithësi përfshin dy faza: vendosjen e një komunikimi të sigurt përmes kutive postare elektronike normale dhe futjen e drejtpërdrejtë të dokumenteve të avokatëve në sistemin e informacionit të gjykatës (“e-filing”). Rezultati i pritshëm i këtij procesi është të zvogëlojë ndjeshëm punën e regjistrave të gjykatave, të cilëve do t’u duhet vetëm të verifikojnë paraqitjen dhe efektet e tyre juridike (hapja e shkresës së lëndës, ndërprerja e një afati të parashkrimit, etj.). Vendet që përdorin këtë mjet po shqyrtojnë rifokusimin e punës së regjistrave të gjykatave në aktivitete juridike me vlerë të lartë dhe ndihmë për gjyqtarët dhe prokurorët.

Rekomandimi 17: Përdorimi i sistemit online të aplikimeve për ndihmë juridike falas duhet të promovohet dhe lehtësohet, përfshirë përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe mjeteve për ndihmë përdoruesve.

Rekomandimi 18: *Mundësia e paraqitjes së thirrjeve përmes mjeteve elektronike, duhet të testohet dhe zbatohet më gjerësisht me rishikimet e nevojshme që dalin gjatë fazës së pilotimit. Nevoja për të dorëzuar njëkohësisht thirrjet në letër duhet të hetohet dhe legjislacioni përkatës të rishikohet nëse është e nevojshme.*

Rekomandimi 19: *Komunikimet elektronike midis gjykatave, avokatëve dhe palëve të tjera të interesit duhet të promovohen fuqishëm si mjete efikasiteti.*

Rekomandimi 20: *Një zgjidhje e-Pagesë për tarifat gjyqësore duhet të zhvillohet, së pari të pilotohet në disa gjykata të zgjedhura dhe më vonë të paraqitet në nivel të Kosovës.*

Rekomandimi 21: *Përdorimi i video-konferencës në procedurat gjyqësore mund të ketë disa përfitime. Megjithatë, përdorimi i tillë nuk duhet të minojë të drejtën për një gjykim të drejtë, siç është mishëruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).*

Gjatë krizës shëndetësore, gjykatave u është dashur të zhvillojnë përdorimin e video-konferencës në procedurat gjyqësore. Siç theksohet në Udhëzimet për video-konferencat në procedurat gjyqësore të miratuara nga CEPEJ më 16-17 qershor 2021, të gjitha garancitë për gjykim të drejtë sipas KEDNJ-së vlejné për seancat në distancë në të gjitha procedurat gjyqësore. Udhëzimet përmbajnë në shtojcë një listë kontrolli të kërkesave themelore për zbatimin e video-konferencës në praktikën gjyqësore.

Rekomandimi 22: *KGJK-ja dhe gjykatat duhet të bëjnë përpjekje shtesë (burime financiare dhe njerëzore) për të përmbushur kërkesat e parashikuara në ligj në lidhje me incizimet në lëndët penale.*

SHTOJCA I - Pyetësi i plotësuar i CEPEJ për TI për Kosovën (të dhënat e vitit 2020)

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Kosovë²⁹ (Projektii KoSEJ2)

PYETËSORI I CEPEJ PËR TI

**PËR VLERËSIMIN E SISTEMEVE GJYQËSORE LIDHUR ME PËRDORIMIN E TEKNOLOGJIVE NË
GJYKATA**

(EKSTRAKT NGA SKEMA E CEPEJ PËR VLERËSIM)

Të dhënat e vitit 2020

6. Buxheti publik vjetor (i miratuar dhe realizuar) i ndarë për funksionimin e të gjitha gjykatave, në € (pa buxhetin e shërbimeve të prokurorisë publike dhe pa buxhetin e ndihmës juridike). Nëse nuk mund ta ndani buxhetin e alokuar për gjykatat nga buxhetet e shërbimeve të prokurorisë publike dhe/ose ndihmës juridike, ju lutemi shkoni te pyetja 7. Nëse jeni në gjendje t'i përgjigjeni pyetjes 6, ju lutemi përgjigjuni NA pyetjes 7.

	Buxheti i miratuar (€)	Buxheti i realizuar (€)
GJITHSEJ - Buxheti vjetor publik i alokuar për funksionimin e të gjitha gjykatave (1 + 2 + 3 + 4 + 5 + 6 + 7)	27,265,668.04	26,283,995.51
1. Buxheti vjetor publik i alokuar për paga (bruto)		
2. Buxheti vjetor publik i alokuar për kompjuterizim	310,000	144,526
3. Buxheti publik vjetor i alokuar për shpenzimet e drejtësisë (ekspertizë, interpretim, etj.).		
4. Buxheti publik vjetor i alokuar për objektet e gjykatave (mirëmbajtja, kostot e funksionimit)		
5. Buxheti publik vjetor i alokuar për investime në objekte (gjykata) të reja		
6. Buxheti vjetor publik i alokuar për trajnime		

²⁹ * Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

7. Tjetër (ju lutemi specifikoni)		
-----------------------------------	--	--

Ju lutemi paraqitni ndonjë koment të dobishëm për t'i shpjeguar shifrat e dhëna. Nëse buxheti vjetor publik i realizuar i alokuar për funksionim të të gjitha gjykatave realisht është i ndryshëm nga buxheti vjetor publik i miratuar i alokuar për funksionimin e të gjitha gjykatave, ju lutemi paraqitni arsyet kryesore të diferencave:

Dallimi në mes të buxhetit të realizuar dhe buxhetit të miratuar është për shkak të faktit se KGJK-ja nuk ishte në gjendje të blinte kompjuterët dhe pajisjet e tjera të TI-së që kishte paraparë të blinte (për shkak të një vonese në shpërndarjen nga operatori ekonomik). 144,526EUR qenë shpenzuar për mirëmbajtjen e sistemit të TI-së. Burime të jashtme nuk përfshihen.

52. Numri i personelit jo-gjyqtar që punon në gjykata (nëse është e mundur më 31 dhjetor të vitit referues) (këto të dhëna nuk duhet të përfshijnë personelin që punon për prokurorët publikë) (ju lutemi jepni informacionin në ekuivalent me orar të plotë dhe për postet e përhershme realisht të plotësuar)

	Total	Burra	Gra
Gjithsej stafi jo-gjyqtar që punon në gjykata (1 + 2 + 3 + 4 + 5)	<u>1532</u> / NA / NAP	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP
1. <i>Rechtspfleger</i> (ose organe të ngjashme) me detyra gjyqësore ose kuazi-gjyqësore që kanë kompetencë autonome dhe vendimet e të cilëve mund të jenë subjekt i apelimit	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP
2. Stafi jo-gjyqtar detyra e të cilit është të <i>ndihmojë gjyqtarët</i> siç janë regjistruarit (përgatitja e shkresës së lëndës, ndihma gjatë seancës, incizimi i gjykimit, ndihma në hartimin e vendimeve)	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP
3. Stafi përgjegjës për detyra administrative të ndryshme dhe të <i>menaxhimit të gjykatave</i> (menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i materialeve dhe pajisjeve, përfshirë sistemet kompjuterike, menaxhimin financiar dhe buxhetor, menaxhimin e trajnimit)	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP
4. Stafi teknik	<u>17</u> / NA / NAP	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP
5. Stafi tjetër jo-gjyqtar	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP	___/ NA / NAP

Nëse “stafi tjetër jo-gjyqtar”, ju lutemi specifikoni; komentet e tjera ju lutemi specifikoni

Në vitin 2020 gjithashtu ishin 27 nëpunës në gjykata që punonin për projektin SMIL (financuar nga Norvegjia).

3.5 Përdorim i teknologjisë së informacionit në gjykata

65-4 A e keni matur ndikimin që rezulton nga zbatimi i një ose disa komponentëve të sistemit tuaj të ri të informacionit?

Po ☐ Jo ☒

65.4.1 Nëse po, a e keni matur ndikimin në: (shumë përgjigje të mundshme)

- ☐ Procese biznesi
- ☐ Ngarkesa pune
- ☐ Burime njerëzore
- ☐ Kosto
- ☐ Tjetër, ju lutemi specifikoni -----

Komente (ju lutemi, specifikoni shembuj të ndikimit)

Projekti SMIL filloi në vitin 2014 dhe po financohet nga Norvegjia. Aktualisht është në fazën e konsolidimit deri në vitin 2021. Që nga janari 2018, ai u vendos gradualisht dhe u zbatua në të gjitha gjykatat. Në vitin 2020 SMIL u vendos dhe u zbatua në të gjitha gjykatat themelore, për të gjitha llojet e lëndëve, përveç në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, ku zbatimi është ende në proces. Ndikimi që rezulton nga zbatimi i këtij sistemi të ri në punën e gjykatave themelore deri më tani nuk është vlerësuar.

3.5.2 Siguria e sistemit të informacionit të gjykata dhe mbrojtja e të dhënave personale

65-5 A ka auditime të pavarura ose mekanizma të tjerë për të kontribuar në politikën globale të sigurisë lidhur me sistemin e informacionit e gjyqësorit?

Po ☒ Jo ☐

Komente (ju lutemi specifikoni veçanërisht nëse ekzistojnë kornizat nacionale të sigurisë së informacionit):

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike: <http://www.zka-rks.org/en/>. Sidoqoftë, ky institucion deri më tani nuk e ka trajtuar çështjen e sigurisë së informacionit dhe të dhënave të mbledhura, të ruajtura dhe të trajtuara nga gjyqësori.

65-6 A sigurohet në nivel legjislativ mbrojtja e të dhënave personale e menaxhuar nga gjykatat?

Po ☒ Jo ☐

Koment: Nëse po, ju lutemi specifikoni ndër të tjera:

- nëse ka autoritete specifiku për përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale
- shtrirja e të drejtave të dhëna qytetarëve në kornizën specifike të softuerit të përdorur nga gjykatat
- nëse ka kontrole ose kufizime me ligj lidhur me ndarjen e databazave të menaxhuara nga gjykatat me administratat e tjera (policinë, etj.)

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>) Ai krijon një institucion përgjegjës për monitorimin e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave - Agjencia e Informimit dhe Privatësisë: <https://aip.rks-gov.net/en/>. Megjithatë, ligji nuk është i qartë për të dhënat personale të menaxhuara nga gjykatat.

3.5.3 Databaza të centralizuara për mbështetje të vendimeve

62-4 A ekziston databaza nacionale e centralizuar e vendimeve të gjykatave (praktika gjyqësore, etj.)?

Po ☒ Jo ☐

62.4.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Për vendime të instancës së parë</i>	<i>Për vendime të instancës së dytë</i>	<i>Për vendimet e instancës së tretë</i>	<i>Lidhja me praktikë gjyqësore të KED-Nj-së</i>	Të dhëna anonime	Databazë e praktikave gjyqësore në dispozicion gratis në internet	Databazë e praktikave gjyqësore në dispozicion në të dhëna të hapura
Civile dhe/ose ekonomike	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	Po ☐ Jo ☒	Po ☒ Jo ☐	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒
Penale	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☐ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	Po ☐ Jo ☒	Po ☒ Jo ☐	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒
Administrative	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	☐ Po, të gjitha aktgjykimet ☒ Po, disa aktgjykime ☐ Jo	Po ☐ Jo ☒	Po ☒ Jo ☐	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Një numër i caktuar aktgjykimesh nga të gjitha gjykatat themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme janë në dispozicion të publikut në uebsajtin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës - <https://www.gjyqesori-rks.org/> (rreth 40000 aktgjykime). Publikohen vetëm aktgjykime përfundimtare. Emrat e palëve janë anonimizuar, bazuar në Udhëzimin Administrativ të KGJK-së të datës 2 shkurt 2016. Procesi i anonimizimit bëhet manualisht nga stafi i gjykatës. Sipas këtij udhëzimi, është e rëndësishme të rritet qasja e publikut në aktgjykime dhe të rritet transparenca e gjyqësorit.

62-6 A ka një regjistër penal nacional të kompjuterizuar që i centralizon të gjitha dënimet penale?

Po ☒ Jo ☐

62.6.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

☐ Lidhja me regjistra penalë të tjerë evropian të së njëjtës natyrë

☐ Përmajtja drejtpërdrejt në dispozicion përmes mjeteve të kompjuterizuara për gjyqtarë dhe/ose prokurorë

☐ Përmajtja drejtpërdrejt në dispozicion për qëllime jo penale (çështje të tjera civile dhe administrative)

Koment - Ju lutemi specifikoni se cili është autoriteti që e lejon qasjen

Sistemi Kombëtar Qendror i Evidencës Penale (NCCR) vitet e fundit, ka punuar në krijimin e një regjistri të centralizuar të kompjuterizuar të dënimeve penale. Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian. Në fund të vitit 2020, kjo databazë u përfundua, por puna për rirregullimin e databazës dhe pastrimin e të dhënave vazhdon. Në vitin 2020, kjo databazë nuk ishte në përdorim. Disa databaza të tjera ishin funksionale dhe u përdorën nga nëpunësit për të përgatitur vërtetime për të kaluarën kriminale. Nuk u përdor nga gjyqtarët.

3.5.4 Mjete ndihmëse shkrimi

62-7 A ka mjete ndihmëse shkrimi për të cilën përmbajtja bashkërendohet në nivel nacional? (modele ose shabllone, paragrafë tanimë të para-shkruar, etj.)

Po ☒ Jo ☐

62.7.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	
Civile dhe/ose ekonomike	✓ 100% 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	
Penale	100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	
Administrative	100% 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Ekzistojnë shabllone për vendime dhe aktgjykime në të gjitha llojet e lëndëve, të cilat janë të disponueshme në Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL). Shabllonet japin paragrafin e parë në fillim të vendimit ose aktgjykimit me informacionin bazë për lëndën, si: emri i gjyqtarit, të dhënat në lidhje me palët, data e vendimit/aktgjykimit, numri i lëndës në SMIL. Ky informacion gjenerohet automatikisht nga SMIL. Shabllonet nuk japin udhëzime të mëtejshme.

62-8 A ka mjete për incizim zëri?

Po ☒ Jo ☐

62.8.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni:

	<i>Disponueshmëria e mjeteve të thjeshta diktimi</i>	<i>Disponueshmëria e mjeteve për incizimin e shumë folësve</i>	<i>Veçoria e njohjes së zërit</i>
Civile dhe/ose ekonomike	☐ të disponueshme në të gjitha gjykatat ☐ të disponueshme në shumicën e tyre ☐ të disponueshme në disa gjykata ose vetëm në disa faza pilot ☐ jo të disponueshme për këtë çështje	☐ të disponueshme në të gjitha gjykatat ☐ të disponueshme në shumicën e tyre ☐ të disponueshme në disa gjykata ose në disa faza pilot ☒ jo të disponueshme për këtë çështje	☐ Po ☐ Testim pilot ☒ Jo

Penale	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose vetëm në disa faza pilot ✓ jo të disponueshme për këtë çështje	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose në disa faza pilot ✓ jo të disponueshme për këtë çështje	○ Po ○ Testim pilot ✓ Jo
Administrative	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose vetëm në disa faza pilot ✓ jo të disponueshme për këtë çështje	○ të disponueshme në të gjitha gjykatat ○ të disponueshme në shumicën e tyre ○ të disponueshme në disa gjykata ose në disa faza pilot ✓ jo të disponueshme për këtë çështje	○ Po ○ Testim pilot - Jo

Koment

Mjetet e incizimit të zërit, të cilat përfshijnë softuer dhe harduer të përdorur në seanca ose si pjesë e procedurave gjyqësore duhet të dallohen nga përdorimi i mjeteve të video-konferencës dhe incizimit të përmendura më poshtë në pyetjet 64-10 dhe 64-11.

Mjetet e incizimit të zërit nuk janë të disponueshme në gjykata. Nuk ka mjete diktimi ose mjete incizim të shumë folësve.

62-9 A ka sajt intraneti brenda sistemit gjyqësor për shpërndarjen e lajmeve/risive?

Norma e disponueshmërisë:

100% - e qasshme për të gjithë në gjyqësor

○ 50-99% - e qasshme për shumicën e gjyqtarëve/prokurorëve në të gjitha instancat

○ 10-49% - vetëm në disa gjykata

○ 1-9% - vetëm në një gjykatë

○ 0% - Pa qasje

NA

Komente - pyetjet 62.1 deri në 62.10

P62-9

Nuk ka asnjë sajt intraneti brenda sistemit gjyqësor. Megjithatë, ekziston një sajt interneti, ku shfaqen informacionet përkatëse (rregulloret e reja dhe udhëzimet administrative) dhe lajmet. Kjo është për KGJK-në dhe të gjitha gjykatat. Shih <https://www.gjyqesori-rks.org/?lang=en>

3.5.5 Teknologjitë e përdorura për administrimin e gjykatave dhe menaxhimin e lëndëve

Përdorimi i teknologjive të informacionit për përmirësimin e efikasitetit të funksionimit të sistemit gjyqësor

63-1 A ekziston sistemi për menaxhimin e lëndëve (SML) ? (Softuer i përdorur për regjistrimin e procedurave gjyqësore dhe për menaxhimin e tyre)

Po ☒ Jo ☐

63.1.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim:

	Norma e disponueshmërisë së SML-së	Statusi i lëndës në internet	Databazë e centralizuar ose e ndër-operueshme	Sinjale të hershme paralajmërimi (për menaxhimin e lëndëve aktive)	Statusi i integritetit/lidhjes së një SML-je me ndonjë mjet statistikor
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☒ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☒ I qasshëm për palët ☐ publikimi i vendimit në internet ☐ Të dyjat ☐ aspak i qasshëm	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒	☐ Plotësisht i integruar përfshirë BI ☒ i integruar ☐ jo i integruar por i lidhur ☐ aspak i lidhur
Penale	☐ 100% ☒ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☒ I qasshëm për palët ☐ publikimi i vendimit në internet ☐ Të dyjat ☐ aspak i qasshëm	Po ☒ Jo ☐	Po ☒ Jo ☐	☐ Plotësisht i integruar përfshirë BI ☒ i integruar ☐ jo i integruar por i lidhur ☐ aspak i lidhur
Administrative	☐ 100% ☒ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☒ I qasshëm për palët ☐ publikimi i vendimit në internet ☐ Të dyjat ☐ aspak i qasshëm	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒	☐ Plotësisht i integruar përfshirë BI ☒ i integruar ☐ jo i integruar por i lidhur ☐ aspak i lidhur

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Sistem për menaxhim të lëndëve

Projekti SMIL filloi në vitin 2014 dhe po financohet nga Norvegjia. Që nga janari 2018 ai u zbatua gradualisht në gjykata. Në vitin 2020 SMIL u vendos dhe u zbatua në të gjitha gjykatat themelore, për të gjitha llojet e lëndëve, kurse në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme SMIL ishte ende në proces të vendosjes dhe zbatimit.

Përdorimi i SMIL-it është i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët, stafin që i ndihmon gjyqtarët drejtpërdrejt dhe personelin administrativ. Lëndët përpunohen dhe menaxhohen përmes SMIL-it nga regjistrimi deri në ekzekutim. Ky është një sistem i bazuar në detyra, që do të thotë se detyrat dërgohen dhe merren automatikisht midis personelit administrativ (kur rastet paraqiten në gjykatë, për shembull), personelit që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët (për të caktuar seanca, etj.) dhe gjyqtarëve (për vendime dhe aktgjykime). Jo të gjitha detyrat mund të kompletohen aktualisht brenda SMIL-it për arsye të ndryshme. Për shembull, duke pasur parasysh se nuk ka komunikim elektronik midis gjykatave dhe avokatëve (siç shpjegohet më poshtë në pikën 3.6.4), thirrjet e gjykatave vazhdojnë të përgatiten me dorë, dhe jo me SMIL. Thirrjet me letër më pas dorëzohen nga zyrtarët e dorëzimit ose me postë të avokatët.

Që nga shkurti 2020, lëndët në gjykata themelore caktohen automatikisht përmes SMIL-it, me disa përjashtime: lëndët paraprake për shembull, dhe anëtarët e panelit (në rastet me një panel prej tre gjyqtarësh) akoma caktohen me dorë. Gjithashtu, kur gjyqtarët ngrihen në pozitë ose transferohen në një departament ose gjykatë tjetër, lëndët nuk mund të ricaktohen automatikisht.

Statusi i lëndës në internet

Në vitin 2020 u zhvillua një funksionalitet i ri në uebsajtin e gjykatave për të kontrolluar statusin e lëndëve në internet. Sidoqoftë, kur u testua në 2021 me qëllim të përpunimit të këtij raporti, ky funksionalitet i ri nuk funksionoi gjithmonë. Ky funksionalitet duhet t'u mundësojë palëve, përfshirë avokatët, të kontrollojnë palët, përfshirë avokatët, mund të kontrollojnë statusin e një lënde duke shënuar numrin e lëndës dhe të shohin nëse lënda i është caktuar një gjyqtari, nëse seancat janë zhvilluar ose do të zhvillohen, nëse lënda ka përfunduar, etj.

Sinjale të paralajmërimit të hershëm

Nuk ka alarme në SMIL, përveç disa njoftimeve për të informuar gjyqtarët se kur do të përfundojnë masat e heqjes së lirisë (të tilla si paraburgimi). Gjyqtarët e intervistuar shpjeguan se ata vazhdojnë të mbajnë gjurmët e afateve vetë, me dorë, me ndihmën e zyrtarëve ligjorë që punojnë me ta.

Mjet statistikor

Një mjet statistikor është i integruar në SMIL. Në vitin 2020, kishte rreth 3 raporte statistikore të disponueshme në SMIL. Një raport monitoron rrjedhën e lëndës: numri i lëndëve të pazgjidhura, të ardhura dhe të zgjidhura, për kategoritë kryesore të lëndës. Një raport tjetër statistikor monitoron vjetërsinë e lëndëve të pazgjidhura. Një raport i tretë monitoron sistemin automatik të caktimit të lëndëve. Raportet shitesë statistikore janë duke u zhvilluar si dhe një modul mbi statistikën.

63-2 Regjistra të kompjuterizuar të menaxhuar nga gjykatat

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	<i>Të dhëna të konsoliduara në nivel nacional</i>	<i>Shërbime të disponueshme në internet</i>	<i>Modul statistikor i integruar ose i lidhur</i>
Regjistri i tokës	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒
Regjistri i biznesit	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒

Koment – nëse ekziston në regjistra të tjerë, ju lutemi specifikoni

Nuk ka asnjë regjistër të kompjuterizuar të menaxhuar nga gjykatat.

Monitorimi buxhetor dhe financiar

63-6 Sistemet e gjykatave për menaxhim buxhetor dhe financiar

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Të dhëna të konsoliduara në nivel nacional</i>	<i>Sistemi që komunikohet me ministri të tjera</i> (në aspektin financiar ndër të tjera)
Menaxhimi buxhetor dhe financiar i gjykatave	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒

Menaxhimi i shpenzimeve gjyqësore	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒
Tjetër	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒

Koment - nëse tjetër, ju lutemi specifikoni:

Pasi procesi i decentralizimit nga KGJK në gjykata ndodhi në vitin 2015, gjykatat mund të bëjnë shpenzime vetë. Gjykatat kanë buxhetin e tyre vjetor dhe përpunojnë të gjitha pagesat përmes sistemit elektronik të Ministrisë së Financave të quajtur "Sistemi informativ i menaxhimit të financave publike". Për shembull, gjykatat përpunojnë pagesën e avokatëve të caktuar nga gjykata sipas detyrës zyrtare, ekspertëve të gjykatave, gjyqtarëve porotë, shërbimet postare për dërgimin e thirrjeve gjyqësore, faturat, etj. Këto pagesa përpunohen manualisht. Për shembull, avokatët dorëzojnë fatura në recepsionin e gjykatës për seancat në të cilat ata kanë marrë pjesë dhe njësia financiare financon pagesën pasi marrjes së miratimit nga disa persona në gjykatë.

Menaxhimi i mjeteve të tjera të gjykatave

63-7 Mjetet e matjes për të vlerësuar ngarkesën e punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe/ose stafit jo-gjyqtar/jo-prokuror (mjet që matë sasinë e aktivitetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe/ose stafit jo-gjyqtar/jo-prokuror - për shembull numrin e lëndëve të zgjidhura)

Po ☒ Jo ☐

Koment

SMIL-i gjeneron një raport statistikor që jep të dhëna për numrin e lëndëve të pazgjidhura, të ardhura dhe të zgjidhura për kategoritë kryesore të lëndëve, për gjykatë dhe gjyqtar. Është parashikuar gjithashtu që SMIL-i të integrojë në të ardhmen një mjet matës për të vlerësuar ngarkesën e lëndëve të gjykatave dhe gjyqtarëve: disa panele për gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave janë hartuar dhe zhvillimi i tyre në SMIL është gati të finalizohet. Mjeti megjithatë do të duhet të mbështetet në numrin faktik të gjyqtarëve dhe stafit, të shprehur në EOP.

63.7.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Të dhëna të përdorura për monitorimin në nivel nacional</i>	<i>Të dhëna të përdorura për monitorimin në nivel lokal të gjykatave</i>	<i>Mjet i integruar në SML</i>
Për gjyqtarë	☐ 100% ☒ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☒ Jo ☐	Po ☒ Jo ☐	Po ☒ Jo ☐
Për prokurorë	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒
Për staf jo-gjyqtar/jo-prokuror	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒

3.5.6 Teknologji të përdorura për komunikim ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve të gjykatave

64-2 A ka mundësi të paraqitjes së një lënde në gjykata përmes mjeteve elektronike?(mundësi për paraqitjen e një lënde përmes mjeteve elektronike, për shembull email ose formular në uebsajt)

Po ☒ Jo ☐

64.2.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	<i>Paraqitja njëkohësisht e lëndëve në formë letre mbetet i detyrueshëm</i>	<i>Kornizë legjislative specifike që autorizon paraqitjen e një lënde</i>	<i>Mjet i integruar/i lidhur me SML</i>
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☒ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒

Koment – nëse ekziston në çështje të tjera, ju lutemi specifikoni

Lëndët civile dhe/ose ekonomike, dhe lëndët administrative

Nuk është e mundur që palët (përfshirë avokatët) të paraqesin lëndë përmes mjeteve elektronike. U lejua përjashtimisht në mars-prill 2020 kur gjykatat u mbyllën për shkak të pandemisë, siç shpjegohet më poshtë (4.1. Aktiviteti i gjykatës gjatë pandemisë).

Lëndë penale

Sistemi SMIL zhvilloi ndërveprimin (transferimin e lëndëve në mënyrë elektronike) nga policia në prokurori dhe nga prokuroria në gjykata. Prandaj, lëndët penale mund të paraqiten nga prokuroria në gjykata përmes mjeteve elektronike, përmes SMIL-it. Avokatët nuk kanë qasje në SMIL.

64-3 A është e mundur të kërkohej ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike?

Po ☒

Jo ☐

64.3.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë</i>	Zyrtarizimi i kërkesës në formë letre mbetet i detyrueshëm	Kornizë legjislative specifike lidhur me kërkesat për ndihmë juridike përmes mjeteve elektronike	Dhënia e ndihmës juridike është edhe elektronike	Informata të disponueshme në SML
Parashtrim i kërkesës në formë elektronike për ndihmë juridike	☒ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Po ☐ Jo ☒	Po ☒ Jo ☐	Po ☐ Jo ☒	Po ☐ Jo ☒

Koment

Në vitin 2020, gjatë mbylljes në mars-prill, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas krijoi një sistem të ri, me mbështetje nga GIZ, për t'u mundësuar njerëzve që të aplikojnë në internet për ndihmë juridike, në uebsajtin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Shih: <https://anjf.rks-gov.net/>. Aktualisht për këtë arsye Agjencia ende merr shumë pak kërkesa online.

64-4 A është e mundur të dërgohen thirrjet për takim gjyqësor ose seancë dëgjimore përmes mjeteve elektronike? (takimi gjyqësor ka të bëjë me faza para një seance dëgjimore gjyqësore, me qëllim të ndërmjetësimit ose pajtimit)

Po ☐ Jo ☒

64.4.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	Thirrje të krijuara përmes SML-it	Thirrja njëkohësisht në formë letre mbetet e detyrueshme	Pëlqim i përdoruesit për t'u njoftuar përmes mjeteve elektronike	Modalitete (nëse tjetër, ju lutemi specifikoni në komente)	Kornizë legjislative specifike
Civile dhe/ose ekonomike	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ SMS ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Penale	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ SMS ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Administrative	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	Po ☐ Jo ☐	☐ SMS ☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Koment

Në vitin 2020, nuk ishte e mundur të dërgoheshin thirrjet gjyqësore përmes mjeteve elektronike tek palët. Sidoqoftë, ishte e mundur që ato të gjeneroheshin nga SMIL. Ka disa shabllone në SMIL për thirrjet, por ky funksionalitet nuk është përdorur sepse atëherë nuk ishte e mundur të dërgoheshin thirrje përmes mjeteve elektronike.

Përdorimi i teknologjive të informacionit për përmirësimin e cilësisë së komunikimit midis gjykatave dhe profesionistëve

64-6 A ka mundësi të komunikimit elektronik midis gjykatave dhe avokatëve dhe/ose palëve? (dërgimi i fajlave dhe të dhënave elektronike në lidhje me një procedurë gjyqësore me ose pa dokumente të skanuar, kryesisht për të zhvilluar komunikimin e dematerializuar)

Komunikim ndërmjet gjykatës dhe avokatëve që përfaqësojnë palë

Po ☐ Jo ☒

Komunikim ndërmjet gjykatës dhe palëve që nuk përfaqësohen nga avokatë

Po ☐ Jo ☒

64.6.1 Nëse po për ndonjërin më sipër, ju lutemi specifikoni informacionin në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Faza të gjykimeve në fjalë</i>	<i>Modalitete</i> (nëse ka dallime sipas fazave të gjykimit ose nëse tjetër, ju lutemi specifikoni në një koment)	<i>Kornizë ligjore specifike</i>
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Paraqitja e një lënde në një gjykatë ☐ Faza përgatitore për seancë dëgjimore ☐ Menaxhim i orarit të seancave dëgjimore dhe/ose apeleve ☐ Dërgim i vendimeve të gjykatës	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Paraqitja e një lënde në një gjykatë ☐ Faza përgatitore për seancë dëgjimore ☐ Menaxhim i orarit të seancave dëgjimore dhe/ose apeleve ☐ Dërgim i vendimeve të gjykatës	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Paraqitja e një lënde në një gjykatë ☐ Faza përgatitore për seancë dëgjimore ☐ Menaxhim i orarit të seancave dëgjimore dhe/ose apeleve ☐ Dërgim i vendimeve të gjykatës	☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
-----------------------	--	--	---	--

Koment

64-7 Termat dhe kushtet e komunikimit elektronik të përdorur nga profesionistë të tjerë jo avokatëve (dërgimi i të dhënave elektronike në lidhje me një procedurë gjyqësore me ose pa dokumente të skanuara, kryesisht për zhvillimin e komunikimit të dematerializuar)

	Norma e disponueshmërisë së mjeteve		Modalitete (nëse ka dallime sipas veprave ose nëse tjetër, ju lutemi specifikoni në një koment)	Kornizë ligjore specifike
Agjentë të ekzekutimit (siç përkufizohet in P169 dhe në vijim)	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA		☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Noterë (siç përkufizohet in P192 dhe në vijim)	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA		☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Ekspertë (siç përkufizohet in P202 dhe në vijim)	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA		☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐
Shërbime të policisë gjyqësore	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☒ NA		☐ Email ☐ Aplikacion kompjuterik specifik ☐ Tjetër	Po ☐ Jo ☐

Koment:

Komunikimi midis gjykatave dhe agjencive të tjera për procedimin e lëndëve bëhet vetëm përmes letrave.

64-9 A ka sisteme përpunimi në internet të kontesteve të specializuara? (konteste me vlerë të ulët, pretendime të padiskutueshme, faza përgatitore për zgjidhje të konflikteve familjare, etj. - ju lutemi, specifikoni në seksionin “komente”)

Po ☐ Jo ☒

Koment – Ju lutemi përshkruani sistemin që ekziston.

Përdorimi i teknologjive të informacionit midis gjykatave, profesionistëve dhe përdoruesve në kornizën e procedurave gjyqësore

64-10 Video-konferencë midis gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve (kjo ka të bëjë me përdorimin e pajisjeve audio-vizuale në kornizën e procedurave gjyqësore siç janë seancat dëgjimore të palëve, etj.)

Po ☒ Jo ☐

64.10.1 Nëse po, specifikoni informacionet në vijim dhe përshkruani në komentet e këtij seksioni rastet e përdorimit real të video-konferencës dhe përfitimet e pritura (për shembull, përdorimi i kësaj pajisje për të ulur numrin e transferimeve të të paraburgosurve në gjykatë):

	Norma e disponueshmërisë	Faza e parashtrimit të padisë	Kornizë legjislative specifike
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% <input type="radio/checkbox"/> (NAP) <input type="radio/checkbox"/> NA	☐ Para seancës dëgjimore ☒ Gjatë seancës dëgjimore ☐ Pas seancës dëgjimore	Po ☒ Jo ☐
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Para seancës dëgjimore ☒ Gjatë seancës dëgjimore ☐ Pas seancës dëgjimor	Po ☒ Jo ☐
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Para seancës dëgjimore ☒ Gjatë seancës dëgjimore ☐ Pas seancës dëgjimor	Po ☒ Jo ☐

Koment

Mjetet e video-konferencës (të tilla si ueb-kamerat, aplikacionet për video-konferencat si Zoom) janë në dispozicion në të gjitha gjykatat themelore. Një projekt i financuar nga USAID dhuroi gjithashtu disa pajisje (kamera dhe mikrofona) gjatë vitit. Për shkak të situatës së pandemisë, disa seanca u mbajtën në internet gjatë vitit 2020.

64-11 Incizimi i seancave dëgjimore ose debateve (incizimi zanor ose audio-vizual gjatë fazës së hetimeve dhe/ose gjykimeve)

Po ☒ Jo ☐

64.11.1 Nëse po, ju lutemi specifikoni informacionet në vijim:

	<i>Norma e disponueshmërisë së mjeteve</i>	<i>Lloji i incizimit</i>	<i>Kornizë legjislative specifike</i>
Civile dhe/ose ekonomike	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Zanor ☐ Video ☐ Të dyjat	Po ☐ Jo ☒
Penale	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☒ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	Zanor ☐ Video ☒ Të dyjat	Po ☒ Jo ☐
Administrative	☐ 100% ☐ 50-99% ☐ 10-49% ☐ 1-9% ☐ 0% (NAP) ☐ NA	☐ Zanor ☐ Video ☐ Të dyjat	Po ☐ Jo ☒

Koment

Sipas nenit 315(2) të Kodit të Procedurës Penale, shqyrtimi gjyqësor “incizohet me audio ose video ose incizohet me mjete stenografike, përveç nëse ka bazë të arsyeshme për të mos vepruar kështu”.

Gjykatat kanë pajisjet për audio dhe video incizim të seancave në disa nga sallat e tyre të gjyqit, por jo të gjitha. Sidoqoftë, duket se pajisjet janë mjaft të vjetruara. Prandaj, në disa gjykata, disa seanca incizohen herë pas here, me kërkesë të gjyqtarit, kur një lëndë është e rëndësishme për shembull, por në disa gjykata të tjera, seancat nuk incizohen kurrë. Kjo çështje është shumë e njohur në sistemin e drejtësisë dhe është raportuar në shumë raporte nga organizatat ndërkombëtare.

64-12 A janë të pranueshme provat elektronike?

Çështja	Pranueshmëria e provave elektronike	Korniza legislative
Civile dhe ekonomike	Po ☒ Jo ☐	✓ Vetëm ligj i përgjithshëm ○ Ligj i përgjithshëm dhe i specializuar ○ Vetëm ligj i specializuar
Penale	Po ☒ Jo ☐	✓ Vetëm ligj i përgjithshëm ○ Ligj i përgjithshëm dhe i specializuar ○ Vetëm ligj i specializuar
Administrative	Po ☒ Jo ☐	✓ Vetëm ligj i përgjithshëm ○ Ligj i përgjithshëm dhe i specializuar ○ Vetëm ligj i specializuar

Koment - Pajisje të tjera të komunikimit elektronik ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve

Ky ligj nuk e specifikon ose ndalon paraqitjen e dëshmive elektronike. Megjithatë, pasi që nuk ka komunikim elektronik midis gjykatave dhe avokatëve, në praktikë provat nuk mund të dorëzohen në mënyrë elektronike.

Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë
Rr. Bedri Pejani nr. 17/18
Prishtinë, 10000

Uebajti: <http://horizontal-facility-eu.coe.int>
Emaili: horizontal.facility@coe.int
Facebook: @jp.horizontal.facility
Twitter: @CoE_EU_HF

Ky publikim u prodhua me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës Instrumenti Horizontal II – projekti KOSEJII. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

SQI

Këshilli i Evropës është organizatë lidere e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ato kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është zotuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e veta me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës